

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR

Pasqyra e Lëndës

.....Faqe

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE faqe 2-6

1.1 Hyrje

1.2 Metoda e auditimit

MBULIMI I AUDITIMIT faqe 6- 36

1. Mbi auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit 6-12

2. Mbi auditimin e menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt projektit..... 12-17

3. Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitin 2017 nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri..... 17-23

4.Mbi auditimin e transaksioneve financiare të pagesave dhe vlerat e raportuara nën Programin e Ndihmës Ekonomike dhe Asistencës Sociale..... 24-25

4/1. Të ndryshme të rezultuara nga auditimi 26-37

5. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm..... 38-38

GJETJET NGA AUDITIMI DHE REKOMANDIMET..... faqe 38- 43

KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT..... faqe 43-44

ANEKSET faqe 45-59

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi projektin “Modernizimi i Asistencës Sociale” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 446/1, datë 19.04.2018, nga data 23.04.2018 deri në datën 8.06.2018, për periudhën nga data 1.01.2017 deri në 31.12.2017. Auditimi financiar u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. N. P, Përgjegjës Grupi
2. M. R, Audituese
3. H. K Auditues.

Gjatë auditimit i është kushtuar një vëmendje e veçantë çështjeve që lidhen me transaksionet financiare për skemën e Ndhmës Ekonomike dhe Pagesës së Aftësisë së Kufizuar, si pjesë integrale e raporteve që i paraqitet Bankës Botërore.

Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit si dhe transparenca me publikun.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të transakcioneve në lidhje me transaksionet financiare për programin e NE dhe PAK të kryera në vitin 2017.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, dt. 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” dhe në kërkesën e Misionit Rezident të Bankës Botërore në Shqipëri, si donator financues i Projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale” SAMP” që implementohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadrin e bashkëpunimit dhe funksioneve që ka KLSH në auditimin e përdorimit me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative ka kryer auditimin financiar të Komponentit 1 të Projektit, Programi i Ndhmës Ekonomike dhe Pagesës së Aftësisë së Kufizuar si dhe plotësimin në përgjithësi të kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar në fuqi.

Çështjet e audituara si dhe drejtimet e auditimit janë :

Auditimi i këtij projekti ka synuar çështje që lidhen me auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, shkaqet dhe argumentimin e ndryshimit të marrëveshjes nëse ka, menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar, mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitin 2017, nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të aplikueshëm në Shqipëri dhe mbi auditimin e transakcioneve financiare të pagesave dhe vlerat e raportuara nën Programin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK e të tjera të rezultuara gjatë auditimit.

Në përfundim të auditimit grupi i auditimit ka dhënë opinionin:

Opinion i Pakualifikuar;

Ne kemi audituar transaksionet financiare të programit të NE dhe PAK të gjeneruara nga sistemi i thesarit. Në gjykimin tonë Pasqyrat Financiare të transakcioneve japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nr. 200)

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH të përshtatura dhe në reference të standardeve ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Auditimi është kryer sipas kërkesave etike, të miratuara me akte ligjore dhe rregullative të cilat janë relevante me kërkesat etike të funksionimit të KLSH. Auditimi i realizuar nga KLSH është i pavarur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dëshmitë e auditimit që janë marrë nga grupi i auditimit janë të njafueshme dhe konform procedurave të miratuara për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ekzaminimi i Raportimit Financiar për vitin 2017 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për Institucionet Supreme të Auditimit të INTOSAI-t, ISSAI 1000-2999, ISSAI 300 dhe ISSAI 400, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit SNA.

Auditimi u fokusua në shqyrtimin e :

- *Raport Progresin e Projektit SAMP, që përfshin Raportet Periodike (3- mujore), të Zyrës së Menaxhimit të Projektit (PMT) në MSHMS për donatorin, Banka Botërore/ IBRD*
- *Raportet Financiare Vjetore të Projektit SAMP, për Programin e Ndihmës Ekonomike, dhe PAK të përgatitura;*
- *Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm në nivel të qeverisjes qendrore MSHMS, Shërbimin Social Shtetëror dhe në nivel të qeverisjes vendore(NJQV)*

Përgjegjësia e Menaxhimit

Njësia e Menaxhimit të Projektit (PIU) ka përgjegjësi të drejtpërdrejt për hartimin e pasqyrës financiare të shpenzimeve për komponentin 2 të marrëveshjes por jo të transaksioneve për programin e NE dhe PAK. PIU nuk ka akses të drejtpërdrejt në sistemin e thesarit por me anë të kërkesave zyrtare mer këtë raport dhe ja bashkëlidh raportit të progresit që i dorëzon Bankës Botërore. Përgjegjësia e transaksioneve është e menaxhimit të MSHMS dhe e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku nëpërmjet strukturave përkatëse nën vartësinë e tyre, mbajnë përgjegjësi për çeljen e fondeve dhe përdorimin e tyre në nivelin e duhur dhe konform rregullave dhe procedurave të miratura në fuqi si dhe konfirmimin e saktësisë së përdorimit të fondeve nën këtë program.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë mbi auditimin e transaksioneve financiarë të pagesave dhe vlerat e raportuara nën Programin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK e të tjera të rezultuara gjatë auditimit në bazë të auditimit tonë. Ne mbajnë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e P/Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi ka vlerësuar nivelin e kontrollit të brendshëm që është në nivelin e duhur përsa i përket transaksioneve për shkak të rakordimeve në nivel qendror dhe sipas NJQV me sistemin e thesarit për cdo hallkë dhe mbulimit me fonde nën programin e Ndhmës Ekonomike dhe Pagesave të Aftësisë së Kufizuar, kjo dhe për vetë faktin e konstatuar të mos trashëgimit të detyrimeve nën këtë program në vitin pasardhës.

Kriteret e vlerësimit.:

Veprimtaria audituese në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Socila për projektin “Modernizimi i Asistencës Sociale” është zhvilluar në përputhje me kërkesat e:
Ligjin nr. 154/2014, “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”;
Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI 300 “Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror”, ISSAI 400 “Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror”, ISSAI 1000 – 2999 “Udhëzues i Auditimit Financiar”;
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar,
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI 300 “Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror”, ISSAI 400 “Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror”, ISSAI 1000 – 2999 “Udhëzues i Auditimit Financiar”;
Ligjin nr. 84/2012, datë 18.09.2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe IBRD për financimin e projektit modernizimi i asistencës sociale” me ndryshimet përkatëse;
Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe vkm e udhëzimet në zbatim të tij;
VKM nr. 452, datë 01.07.1998 “Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;
Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”,
Ligji nr. 9355, datë 10/03/2005 “Për ndihmën dhe shërbimin shoqëror”, të ndryshuar;
VKM nr. 787, datë 14/02/2005 “Për përcaktimin e kriterëve e procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”,
VKM nr. 904, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” me ndryshimet dhe Udhëzuesit përkatës të huadhënësit dhe/ose bashkëfinancuesve të tjerë për prokurimet e fondeve të ndërtimit, makineri-pajisje, shërbime të konsulencës, të projekt-preventivit, të supervizionit;
Akte nenligjore dhe udhëzime në drejtim të financimit të NE dhe PAK.

është përcaktuar sipas gjykimit të shumave të transferuara NJQV dhe problematikës së mundshme të evidentuar paraprakisht.

Përshkrimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar Raportet Financiare Vjetore të Programit Ndihma Ekonomike (NE), dhe Pagesa të Aftësisë së Kufizuar (PAK) të përgatitura nga Projekti “*Modernizimi i Asistencës Sociale*” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) raporton një opinion për vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare. Ekzaminimi i Raporteve Financiare për vitin 2017, është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për Institucionet Supreme të Auditimit ISSAI 1000-2999, të INTOSAI-t, ISSAI 200, ISSAI 300 dhe ISSAI 400 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, SNA, duke fokusuar veprimtarinë në transaksionet financiare të kryera nën Programin e NE dhe PAK si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin lidhur me fondet e lëvruara nën këtë komponent. Mbështetur në këto Standarde ky auditim është planifikuar dhe kryer duke arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat dhe raportet financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Auditimi i Programit të Ndhmës Ekonomike u realizua me përzgjedhje të njëjësive vendore për transaksionet e vitit, evidencës mbështetëse (vendimet e Këshillave Bashkiak, vendimet e drejtorive rajonale për rezultatet nga sistemi, listë pagesat e konfirmuara nga bankat e nivelit të dytë dhe Posta Shqiptare, rakordimet me thesarin për fondet e përdorura përputhshmëria e raporteve me raportimet e paraqitura në Raportin Financiar të Vitit 2017). Auditimi përfshin vlerësimin e parimeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar të përdorura po ashtu dhe pasqyrimin e deklaratave financiare në përgjithësi.

Për komponentin e parë të Projektit, si rezultat i miratimit të vonuar të shtyrjes së afatit të zbatimit të Projektit, rezultat dhe i ndryshimeve të titullarëve dhe strukturore të Kabinetit Qeveritar, rezultuar nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, nuk u realizuan disa aktivitete të lidhura me indikatorët që janë në proces dhe të porealizuar. Gjithashtu shtrirja e skemës së modernizimit të asistencës sociale për programin e NE në tërë territorin e Shqipërisë (mbarëkombëtar) kërkon kuptimin, bashkëveprimin pozitiv, përgjegjësinë, profesionalizmin dhe përkushtimin e një numri të madh institucioneve (NJQV, Drejtori Rajonale SHSSH, etj) dhe punonjësish që realisht përbëjnë një sfidë në realizimin e këtij projekti brenda afatit të amenduar deri më 31 Dhjetor 2018 duke presupozuar dhe problemet që rezultojnë hap pas hapi nga implementimi i formulës së pikëzimit apo i procedurave të reja të aplikuara për përfituesit e PAK.

Për vitin 2017 nën Komponentin 1, shpenzimet aktuale për “*Ndhmën Ekonomik*”, për periudhën objekt auditimi 1 janar – 31 Dhjetor 2017, përfshijnë shumën në cash **4,819,355.56 mijë** lekë dhe për PAK **15,744,063.12 lekë në total 20,563,398.68 mijë lekë**.

Objekt i këtij auditimi është vërtetësia e transaksioneve financiare nga financimi deri tek përfituesi nën Programin e NE dhe PAK të përgjatë periudhës së vitit 2017, konform procedurave ligjore të çeljes dhe transferimit të tyre në llogaritë e përfituesve.

Qëllimi i auditimit: Është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar

Raporti që i dorëzohet Bankës Botërore bëhet sipas kërkesave dhe termave të miratuara nga banka.

Metoda e Auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e rregullshmërisë financiare u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme.

Përcaktuam materialitetin në masën 2% për zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, duke përcaktuar faktorin e riskut (0.7%).

Mbasi përcaktuam materialitetin dhe faktorin e riskut për këtë fushë rezultuan çështjet për tu shqyrtuar për zonat e llogarisë 606 "Ndihma ekonomike".

Në auditimet e kryera morëm parasysh materialitetin dhe auditimin mbi bazë risku duke audituar të gjitha transaksionet financiare që lidhet me Ndihmën Ekonomike dhe PAK në dy bashki dhe dy njësi administrative në Tiranë.

U mbështetëm në punën e auditit të brendshëm pasi kjo strukturë është e ngritur dhe është pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe mund të japë siguri për operacionet dhe procedurat e në vazhdim.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua edhe struktura e autoriteteve si legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, shumat e autorizuara për 2017, struktura organizative, caktimi i përgjegjesisë dhe autoritetit, burimet njerëzore, etj

Për t'u siguruar që fondet buxhetore janë të plota dhe të vlefshme u audituan zonat e llogarisë 606 "Ndihma ekonomike", për të parë nëse veprimet janë të rregullta, të plota dhe të regjistruara.

Në përfundim të procesit të auditimit për secilin drejtim të Auditimit, rezultoi për sa më poshtë vijon:

MBULIMI I AUDITIMIT

1. Mbi auditimin e marrëveshjeve të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit .

Projekti "Modernizimi i Asistencës sociale " financohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në formën e Huas me numër 8141-AL, marrëveshja e së cilës është ratifikuar me ligjin Nr. 84/2012 ndërmjet Shqipërisë dhe IBRD miratuar më 18.09.2012 dhe shpallur në dekretin nr. 7 775, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Banka ka rënë dakord ti japë hua Huamarrësit shumë prej 38,000,000 (tridhjetë e tetë milion) Euro, shumë e cila sipas dispozitave të marrëveshjes mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet konvertimit të monedhës për të ndihmuar financimin e projektit. Tarifa fillestare e pagueshme nga Huamarrësi do të jetë e barabartë me çerekun e një pike përqindjeje (0.25%) të shumës së huas.

Periodha e implementimit të projektit është 5 vjet dhe data e mbylljes e përcaktuar në marrëveshje është 30 Qershor 2017.

Projekti "Modernizimi i Asistencës sociale " ka si objektiv mbështetjen e implementimit të reformave qeveritare për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të asistencës sociale. Gjithashtu ai do të promovojë principin e transparencës për të mbështetur objektivat e tij dhe do të kontribuojë në reduktimin e varfërisë nëpërmjet shërbimeve me efektive të asistencës sociale. Projekti do ti arrij objektivat e tij nëpërmjet implementimit të dy komponentëve:

Komponenti 1 *Forcimi i zbatimit dhe performancës së programit të Asistencës Sociale*

Komponenti 2 Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale

Të dy këta komponentë janë të ndërlidhur nëpërmjet kuadrit të rezultateve. Konkretisht, asistenca teknike për përmirësimin e sistemeve në kapacitetet qeveritare e mbështetur nga komponenti 2, do të kontribuojë në përmirësimin e implementimit të programeve të asistencës sociale dhe në arritjen e rezultateve që do të shkaktojnë disbursimet nën komponentin 1.

Kategoritë e miratuara të cilat mund të financohen nga të ardhurat e huas janë pagesa për programin e shpenzimeve të miratuara në kuadër të komponentit 1 të projektit, shërbimet e konsulentëve në kuadër të pjesës 2 të projektit si dhe tarifa fillestare.

Përsa i përket instrumentit të huadhënies, projekti do të jete i trajtës Hua Specifike për Investime, e cila do të disbursohet në dy mënyra a) me disbursime për arritje të verifikuara të rezultateve për implementime dhe përmirësime në programin kryesor të asistencës sociale duke përdorur qasjen “ financimin në baze të rezultateve” për komponentin 1 b) pagesa për kundërshtimet deklarative të shpenzimeve për inpute që lidhen me aktivitetet e asistencës teknike për komponentin 2.

Gjithashtu bazuar në Marrëveshjes së Huas, Huamarrësi ka detyrimin që nëpërmjet MMSR-së, të raportojë, monitorojë dhe vlerësojë progresin e projektit mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën. Këto raporte mbulojnë një periudhë 3 mujore dhe i dorëzohen bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

Nga Njësia e Menaxhimit të Projektit në funksion dhe në kërkesë të Marrëveshjes së Huas janë dërguar Bankës Botërore Raport Progresit 3 mujore për vitin 2017 sipas afateve të përcaktuara si më poshtë:

- Me shkresën nr.115, dt. 28.04.2017 “Dërgohet Raporti Progres 3-mujor (01 janar – 31 mars 2017) i zbatimit të projektit të modernizimit të asistencës Sociale (SAMP)”;
- Me shkresën nr. 181, dt. 30.07.2017 “Dërgohet Raporti Progres 3-mujor (01 prill – 30 qershor 2017) i zbatimit të projektit të modernizimit të asistencës Sociale (SAMP)”;
- Me shkresën nr. 218, dt. 31.10.2015 “Dërgohet Raporti Progres 3-mujor (01korrik – 30 shtator 2017) i zbatimit të projektit të modernizimit të asistencës Sociale (SAMP)”;
- Me shkresën nr. 29, dt. 31.01.2018 “Dërgohet Raporti Progres 3-mujor (01 tetor – 31 dhjetor 2018) i zbatimit të projektit të modernizimit të asistencës Sociale (SAMP)”.

Ndër të tjera Huamarrësi auditon pasqyrat financiare që lidhen me projektin në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha i dorëzohet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe; dhe vihen në dispozicion të publikut në një kohë dhe mënyrë që është e pranueshme për Bankën.

Gjatë periudhës së auditimit është konstatuar se nuk ka ende një njoftim për auditim për periudhën Janar-Dhjetor 2017, por sipas afateve kohore të përcaktuara në marrëveshje ka ende dhe një muaj kohe për dorëzimin e Pasqyrave financiare të audituara për vitin 2017.

Referuar parashikimit në marrëveshje, sa më sipër cituar, detyrimi për realizimin e auditimit të pasqyrave financiare është i huamarrësit, pra i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga Njësia e Projektit nuk na rezultoi komunikim zyrtar me huamarrësin direkt,

në lidhje me iniciimin e procedurave për auditimin e pasqyrave financiare pavarësisht përgjegjësisë dhe detyrimit për këtë proces.

Presa i përket auditimit të pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2016, raporti i auditimit të pavarur mban datën 1 dhjetor 2017, pra afati prej 6 muajsh i dorëzimit të tij është tejkaluar me mbi 6 muaj të tjerë.

Ne faqet web përkatëse të Ministrive nuk janë vene ne dispozicion të publikut pasqyrat financiare sipas kushteve të marrëveshjes detyrim i huamarresit.

Marrëveshja e huasë është ndryshuar dy herë.

Për realizimin e gjithë aktiviteteve të parashikuara për realizimin e treguesve që lidhen me disbursimet (TLD) në PAD e miratuar në datë 17.02.2012 burimet e financimit për një pjesë të aktiviteteve parashikoheshin të financohen nga Shtetit Shqiptar dhe/ose nga Bashkimi Europian.

Duke qenë se fondi IPA 2013 nuk u sigurua, aktivitetet e parashikuara u menduan të financohen nga ristrukturimi i kredisë.

Amendimi i parë i realizuar me Ligjin Nr. 117/2016 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës sociale”, ratifikuar me ligjin nr. 84/2012”, ka të bëjë me ndryshimin në seksionin IV. A. 2 të skedulit 2 (Tërheqja e kësteve të Huas) ku konkretisht zvogëlohet me 4.5% shuma e huas së alokuar për kategorinë 1. Pagesa për programin e shpenzimeve të miratuara në kuadër të komponentit 1 të projektit nga vlera 36,765,000 Euro përcaktohet ne vlerën 35,115,000 Euro. Ndërkohë që rritet me mbi 144 % shuma e huas së alokuar për kategorinë 2. Shërbimet e konsulentëve sipas komponentit 2 të projektit nga vlera 1,140,000 Euro përcaktohen 2,790,000 Euro. Tarifa fillestare mbetet e njëjtë po ashtu dhe shuma totale e Huas.

Kategoria	Shuma e huas së alokuar sipas Ligjit 82/2012 (Euro)	Shuma e huas së alokuar sipas Ligjit117/2016 (Euro)	Diferenca (Euro)	Diferenca Përqindje (%)
Pagesa për programin e shpenzimeve në kuadër te komponentit 1	36,765,000	35,115,000	-1,650,000	- 4,48
Shërbimet e konsulentëve në kuadër të komponentit 2	1,140,000	2,790,000	1,650,000	+ 144,73
Tarifa fillestare	95,000	95,000	0	0

Gjithashtu ndryshohet shtojca 2 e Programit që ka të bëjë me Treguesit qe lidhen me Disbursimet TLD si më poshtë.

TLD 4- Ka ndryshuar shuma e DLI e shprehur në euro në 2,500,000 nga 1,900,000 që ka qenë në marrëveshjen e ratifikuar në 2012.

TLD 7- Ka ndryshuar shuma e shprehur ne euro ne 2,500,0000 për 66 % nga 1,900,000 që ka qenë në marrëveshjen e ratifikuar 2012.

TLD 14- Është ndryshuar përqindja e njërive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në 2 rajonet pilote nga 90 që ka qenë në marrëveshjen e ratifikuar 2012 ne 66 %.

TLD 15- Ky tregues është hequr fare.

Ndryshimet me aktet e paraqitura si mësipër pasqyrohen në tabelën sa më poshtë vijon.

Nr.	Treguesi që lidhet me disbursimet (DLI) Sipas Marrëveshjes 2012	Shuma e DLI (shprehur në euro)	Ndryshimet sipas Marrëveshjes 2016
-----	---	--------------------------------	------------------------------------

1	Të paktën 90 për qind e administratorëve socialë në tri rajonet pilote janë trajnuar rreth zbatimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për programin e ndihmës ekonomike	1,045,000	Ka mbetur e njëjtë
2	Të paktën 80 për qind e familjeve në tri rajonet pilote, të cilat marrin përfitime për programin e NE janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit për të cilën është rënë dakord me Bankën	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë
3	Të paktën 80 për qind e dosjeve të kërkuarve të NE në tri rajonet pilote janë plotësuar dhe në përputhje me proceset e aplikimit dhe hyrjes, duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit, të specifikuar në udhëzimet operationale të NE për të cilat është rënë dakord me Bankën	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë
4	<i>Të paktën 80 për qind e familjeve në nivel kombëtar, të cilat po marrin përfitimet për programin e NE janë kontrolluar për pranueshmërinë e tyre duke përdorur formulën e unifikuar të pikëzimit për të cilën është rënë dakord me Bankën</i>	<i>1,900,000</i>	<i>Ka ndryshuar shuma e DLI e shprehur në euro në 2,500,000</i>
5	Kritere vlerësimi, procedura biznesi dhe marrëveshje institucionale të rishikuara për PAK bazuar në modelin social janë hartuar dhe para testuar	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë
6	Kriteret e vlerësimit, procedurat e biznesit dhe marrëveshjet institucionale për PAK janë rishikuar bazuar në modelin social dhe këto rishikime janë konsultuar, miratuar dhe shpërndarë	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë
7	<i>Të paktën dy të tretat e përfituesve ekzistues të PAK, të cilët janë subjekt i një ricertifikimi vjetor, janë rivlerësuar duke përdorur kriteret dhe proceset e rishikuara bazuar në modelin social</i>	<i>1,900,000</i>	<i>Ka ndryshuar shuma e shprehur në euro në 2,500,000 për 66 %</i>
8	Faza e parë e MIS NE është zhvilluar dhe testuar, duke përfshirë modulet funksionale për një regjistër kombëtar për aplikantët në NE, zgjedhjen e familjeve, futjen në program, nxjerrja e urdhrit të pagesës dhe raportimin	2,090,000	Ka mbetur e njëjtë
9	Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në tri rajonet pilote përdorin MIS për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, hyrjen në program dhe urdhërpagesat e NE	2,850,000	Ka mbetur e njëjtë
10	Informacioni familjar dhe/ose individual i regjistruar për përfituesit në MIS NE është kontrolluar në mënyrë të kryqëzuar me informacionin përkatës në të paktën 3 sisteme qeveritare të informacionit (siç janë regjistri i taksave, punësimi, qarkullimi rrugor, gjendja civile, regjistrimi i bizneseve apo sistemi i pensioneve)	2,850,000	Ka mbetur e njëjtë

11	Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në nivel kombëtar përdorin MIS NE për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, hyrjen në program dhe urdhërpagesat e NE; dhe MIS NE është zgjeruar për të mbuluar funksionet e fazës së dytë, duke përfshirë një modul të informacionit të biznesit për monitorim dhe vlerësim	2,850,000	Ka mbetur e njëjtë
12	Faza e tretë e MIS NE është zhvilluar dhe testuar, me funksione të zgjeruara që përfshijnë një modul “për menaxhim të integruar të rasteve” dhe një lidhje me sistemin e thesarit për të mundësuar përputhjen e pagesave elektronike të automatizuara	2,090,000	Ka mbetur e njëjtë
13	Faza e parë e MIS PAK është zhvilluar dhe testuar, duke përfshirë module funksionale për një regjistër kombëtar të aplikantëve të rinj dhe përfituesit ekzistues të PAK, vlerësimi i për pranueshmërisë së tyre, ricertifikimi, futja në program, nxjerrja e urdhërpagesave dhe raportimin	2,090,000	Ka mbetur e njëjtë
14	<i>Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në 2 rajonet pilote, të përzgjedhura në konsultim me Bankën, përdorin MIS PAK të automatizuar për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve të rinj të PAK dhe futjen në program; për regjistrimin e vendimeve të ricertifikimit për përfituesit ekzistues; dhe për nxjerrjen e urdhërpagesave për përfituesit e rinj dhe ata ekzistues.</i>	<i>2,850,000</i>	<i>Është ndryshuar përqindja e njësive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në 2 rajonet pilote nga 90 në 66 %</i>
15	<i>Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit vendor (bashki/komuna) në nivel kombëtar përdorin MIS PAK të automatizuar për të përpunuar regjistrimin e aplikantëve të rinj të PAK dhe futjen në program; për regjistrimin e vendimeve të ricertifikimit për përfituesit ekzistues; dhe për nxjerrjen e urdhërpagesave për përfituesit e rinj dhe ata ekzistues; dhe MIS PAK është zgjeruar për të përfshirë funksione të fazës së dytë, përfshirë integrimin e të dhënave nga vlerësimi i rishikuar i pranueshmërisë së tyre bazuar në modelin social</i>	<i>2,850,000</i>	<i>Është hequr</i>
16	Të paktën 75% e rasteve të dyshuara për mashtrim dhe gabime në NE dhe PAK janë hetuar nga inspektorët sociale në përputhje me politikën dhe legjislacionin e rishikuar të sanksioneve	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë
17	Është zbatuar profilizimi me bazë riskun për zbulimin e gabimeve dhe mashtrimin në NE dhe PAK	1,900,000	Ka mbetur e njëjtë

Gjithashtu marrëveshja sa më sipër referuar ligjit 117/2016 datë 10.11.2016, ka ndryshime dhe në përkufizime ku shtesa (përkufizimet) e marrëveshjes amendohet si vijon:

a) Paragrafi 10, fshihet tërësisht dhe zëvendësohet me paragrafin më poshtë:

“MMSR” ka kuptimin Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Huamarrësit, “Si rrjedhojë, të gjitha referencat për “MPCS” te Marrëveshja amendohen mutatis mutandis, që të lexohen “MMSR”.

Amendimi i dytë i marrëveshjes është bërë me Ligjin Nr. 113/2017 “Për ratifikimin e dokumenteve ndryshues të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim IBRD, për financimin e projektit “Modernizimi i asistencës sociale”, të ratifikuar me ligjin nr. 84/2012”, ka të bëjë me shtyrjen e datës së përfundimit të projektit me 31 Dhjetor 2018, si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B.4, të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas, i miratuar më 14.12.2017 dhe i shpallur në dekretin nr. 10704 datë 26.12.2017.

Gjithashtu në këtë amendim shtohet se është vërejtur se në ndryshimin e Marrëveshjes së Huas, të datës 16 maj 2016 (Amendamenti), janë përjashtuar pa dashje taksat nga shpenzimet që financohen nga të ardhurat e Huas, te cilat korrigjohen në këtë amendim dhe përfshihen në IV.A.2 të skedulit 2 (Tërheqja e kësteve të Huas) për kategorinë 2. Shërbimet e konsulentëve në kuadër të pjesës 2 të projektit dhe kostot operative.

Procedura e amendimit të dytë ka nisur me kërkesën e huamarrësit drejtuar Bankës Botërore më datë 26 Janar 2017 për zgjatjen e datës së mbylljes së projektit. Kjo marrëveshje duhet të përfundonte në 31 qershor të vitit 2017, por si rezultat i ndryshimeve të përcaktuara në amendamentin e parë sipas ligjit 117/2016 të cilat nuk u shoqëruan me ndryshimet kohore, projekti nuk arriti të përfundonte sipas afatit të përcaktuar.

Edhe pse datat e aplikimit për ndryshimet shënojnë Janar 2017, për shkak të situatave politike në Shqipëri miratimet nga kuvendi ka zgjatur deri në Dhjetor 2017.

Gjetje 1.

Gjatë periudhës së auditimit është konstatuar se nga Huamarrësi nuk ka ende një njoftim për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2017, por sipas afateve kohore të përcaktuara në marrëveshje dhe momentit të auditimit nga grupi i KLSH ka ende dhe një muaj kohe për përfundimin e këtij afati. Gjithashtu referuar parashikimit në marrëveshje, detyrimi për realizimin e auditimit të pasqyrave financiare është i huamarrësit, pra i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga Njësia e Projektit nuk na rezultoi komunikim zyrtar me huamarrësin direkt, në lidhje me iniciimin e procedurave për auditimin e pasqyrave financiare pavarësisht përgjegjësisë dhe detyrimit për këtë proces. Në faqet web përkatëse të Ministrive nuk janë vene ne dispozicion te publikut pasqyrat financiare sipas kushteve te marrëveshjes, detyrim i huamarrësit.

Nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit në observacionin për Projektin Raportin dërguar me shkresën nr.2579/9 datë 27.07.2018 për citimin “Nga Njësia e Projektit nuk na rezultoi komunikim zyrtar me huamarrësin direkt, në lidhje me iniciimin e procedurave për auditimin e pasqyrave financiare pavarësisht përgjegjësisë dhe detyrimit për këtë proces”, është bërë observacion duke theksuar që referuar marrëveshjes, nuk është në funksionet e kësaj njësie kontraktimi i audituesve të Pasqyrave Financiare, por i huamarrësit. Për këtë observacion japim këtë opinion.

Nga grupi i auditimit si gjatë trajtimit në materiale ashtu dhe në konkluzionin e gjetjes është theksuar që kjo përgjegjësi nuk është e njësisë, por referuar faktit të përsëritur dhe të konstatuar se këto pasqyra financiare janë audituar tej afateve të përcaktuara në marrëveshje, grupi ka cituar një realitet. Rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit nuk çënon, kompetencat as të Njësies së Projektit por dhe as të Huamarrësit dhe vetëm i shërben procesit të zbatimit të kërkesave të përcaktuara në marrëveshje për këtë qëllim.

Rekomandim:

Nga njësia e projektit te merren masa qe me shkresën përcjellëse të dorëzimit të pasqyrës financiare për vitin përkatës në Ministri të Financës dhe Ekonomisë, të theksohet dhe të iniciohet disponueshmëria e njësisë së projektit për auditimin e pasqyrave financiare, referuar afateve të përcaktuara në marrëveshjen e huas, brenda muajit Qershor, si dhe vënies ne dispozicion të tyre për publikun, mbas auditimit, nëpërmjet faqes web edhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që luan rolin e liderit në zbatimin e këtij projekti.

Vazhdimisht

2. Mbi auditimin e menaxhimit financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt projektit.

Huamarrësi mund ti tërheqë fondet e huas në përputhje me dispozitat e marrëveshjes dhe udhëzimeve që mund të specifikohen nga banka me njoftim për huamarrësin, për financimin e shpenzimeve te miratuara te projektit, përkatësisht; në lidhje me komponentin 1 të projektit, si rimbursim të një pjese programit të miratuar të shpenzimeve; në lidhje me komponentin 2 të projektit për të financuar shërbimet e konsulentëve dhe kostot operative; në lidhje me tarifën fillestare të referuar në paragrafin 2.03 të marrëveshjes.

Në marrëveshje specifikohen gjithashtu kushtet dhe periudha e tërheqjes. Asnjë tërheqje nuk mund te behet :

- a) Për pagesa të bëra para datës së marrëveshjes
- b) Për pagesa në kategorinë 1 në lidhje me secilën shumë të treguesve të lidhur me disbursimin- DLI të përcaktuar në shtojcën 2 të marrëveshjes.

Për komponentin 1 disbursimet përbëhen nga 17 transhe tërheqja e te cilave mund të behet kundrejt kërkesës për disbursim dhe verifikimit të ekipit në detyrë të Bankës Botërore për :

- (i) Pajtueshmërinë dhe arritjen e Treguesve që lidhen me Disbursimet (ILD)
- (ii) Kushtin që buxheti i shtetit ka lëvruar fonde të mjaftueshme për të mbuluar disbursimin
- (iii) Përmbushjen e kushtit global të disbursimit për ruajtjen e indeksimit te inflacionit për përfitimet e aftësisë së kufizuar
- (iv) BB do të disbursojë shumën e shpenzimeve të ligjshme të shkaktuara nga përmbushja e Indikatorëve Lidhur me Disbursimet.

Për vitin 2017 plani vjetor i aktiviteteve të projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale parashikonte 22 aktivitete që lidhen me komponentin 2 “ Asistenca teknike për fuqizimin e kapaciteteve në programet e asistencës sociale”. Këto aktivitete kanë të bëjnë kryesisht me realizimin e Indikatorëve që Lidhen me Disbursimet ILD 7 dhe ILD 14, por gjithashtu lidhen dhe me realizimin e indikatorëve ILD 4, ILD 11, ILD 12 dhe ILD 14.

Bazuar ne Progres Raportet 3 mujore te zbatimit te projektit Modernizimi i Asistencës Sociale rezulton se këto aktivitete te parashikuara janë realizuar si me poshtë:

Aktivitete nënkategorisë 2A- Rishikimi i parametrave të programit për një barazi të përmirësuar. Për këtë kategori për vitin 2017 janë parashikuar 6 aktivitete që kanë të bëjnë me kontrata konsulence dhe nga auditimi rezulton se vetëm 2 kontrata janë mbyllur plotësisht në vitin 2017, 2 janë në proces realizimi dhe 2 të tjera nuk kanë filluar ende.

Aktivitetet që nuk kanë filluar ende i referohen kryesisht indikatorëve që lidhen me disbursimin (ILD) 4- "Të paktën 80 për qind e familjeve në gjithë vendin që po përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike janë shqyrtuar për kriteret e pranueshmërisë, duke përdorur formulën e unifikuar të unifikuar të pikëzimit të rënë dakord me Bankën", ILD 11- "Të paktën 90 për qind e njësive të pushtetit lokal (bashki/komuna) në gjithë vendin përdorin Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të ndihmës ekonomike të automatizuar për të trajtuar regjistrimin për ndihmë ekonomike të aplikantëve, përzgjedhjen e përfituesve, regjistrimin në program dhe urdhrat e pagesës; dhe Sistemi i Informacionit të Menaxhimit i Ndihmës Ekonomike zgjerohet për të mbuluar funksionet e fazës së dytë, duke përfshirë një modul inteligjence për biznesin për monitorim dhe vlerësim", dhe ILD 12- "Faza e tretë e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Ndihmës Ekonomike zhvillohet dhe testohet, me funksione të zgjeruara që përfshijnë një modul për "Menaxhim të integruar të rasteve" dhe një lidhje me sistemin e Thesarit për të mundësuar një rakordim/përputhje të automatizuar të pagesave elektronike".

Aktivitete te nënkategorisë 2B- Fuqizimi i Administrimit të Përfitimeve për një efikasitet të përmirësuar. Për këtë kategori për vitin 2017 janë parashikuar 6 aktivitete. Nga auditimi rezulton se 3 kontrata janë mbyllur plotësisht, 1 kontrate rezulton ende në zbatim si rezultat i miratimit të zgjatjes së datës së mbylljes së projektit, ndërsa 2 aktivitete të parashikuar në 2017 nuk janë realizuar.

Aktivitete te nënkategorisë 2C-Promovimi i transparencës nëpërmjet komunikimit, monitorimit dhe vlerësimit Për këtë kategori për vitin 2017 janë parashikuar 7 aktivitete. Nga auditimi rezulton se vetëm 1 aktivitet është realizuar plotësisht, 1 aktivitet është ende në proces, prokurimi i të cilit sipas progres raportit janar 2018 do të mbyllet pas miratimit të datës së rishikuar të mbylljes së projektit, ndërkohë që 5 aktivitete të parashikuar për vitin 2017 nuk janë realizuar.

Aktivitete të nënkategorisë 2D- Mbështetje për zbatimin e projektit janë parashikuar 3 për vitin 2017 dhe janë realizuar 2.

Aktivitete parashikuar për 2017	Realizuar	Në proces	Pa realizuar
22	8	4	10

Për katër kategoritë e cituara me sipër, referuar dhe ballafaqimit dhe argumentimit të njesisë së projektit, mos realizimi i aktiviteteve të parashikuar për vitin 2017 justifikohet me ndryshimet e kabinetit qeveritar, mënyra e organizimit të Këshillit të Ministrave (Bashkimi i programeve të dy Ministrive, asaj të Shëndetësisë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe amendimi i vonuar i miratimit të datës së zgjatjes së projektit .

Për sa i përket arritjes së indikatorëve për vitin 2017, më 20 Qershor 2017 Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka dërguar pranë Bankës Botërore të gjithë dokumentacionin mbështetës që konfirmon arritjen e ILD 7, ILD14 të parashikuar për këtë vit dhe kushtit Global GDC përkatësisht me shkresat:

1. Shkresa Nr. 3367/4 datë 20.06.2016 " Mbi realizimin e indikatorit ILD7", e cila përmban bashkangjitur:

- kopje të shkresës zyrtare të SHSSH me përlogaritjen e ILD7, Nr. 1167 date 14.06.2017
- kopje të shkresës zyrtare të dërguar nga zyra e njësive administrative nr. 6 dhe nr 7,
- raportin mujor të monitorimit të SMI për PAK të gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të informacionit për programin e aftësisë së kufizuar,

- shkresën e njoftimit të DR për listën e aplikuesve përfitues dhe te refuzuar.

Referuar protokollit për arritjen e indikatorit të disbursimit ILD 7 ku sipas te cilit kërkohet që “Të paktën 66% e aplikimeve të reja dhe kërkesave për ricertifikim në dy zonat pilot janë vlerësuar/rivlerësuar duke përdorur kriteret dhe proceset e rishikuara bazuar në modelin social”, ku rezulton se ky indikator për periudhën 26 Prill 2017- 9 Qershor 2017 është realizuar në masën 79%.

2. Shkresa Nr. 3367/3 datë 20.06.2016 “Mbi realizimin e indikatorit ILD14”, e cila përmban bashkangjitur:

- Kopje të shkresës zyrtare te SHSSH me përlllogaritjen e ILD14, Nr. 1166 date 14.06.2017
- Kopje e listë pagesës se bashku me ID dhe masën e përfitimit të pagesës për secilin aplikues në të dyja njësite pilot, Nr. 747/1 date 09.06.2017
- Raporti i modulit te MIS-it për aktivitetin e ngarkesës se bazës se te dhënave për përfituesit e PAK nga Drejtoria Rajonale e SHSSH.

Referuar protokollit për arritjen e indikatorit të disbursimit ILD 14 ku sipas te cilit kërkohet që Të paktën 66% e aplikimeve të reja dhe kërkesave për ricertifikim në dy zonat pilot janë proceduar duke përdorur sistemin e menaxhimit te informacionit për përfituesit e aftësisë se kufizuar te automatizuar, ku rezulton se ky indikator për periudhën 26 Prill 2017- 9 Qershor 2017 është realizuar ne masën 79%.

3. Shkresa Nr. 3367/2 datë 20.06.2016 “ Mbi realizimin e Protokollit të Kushtit Global të Disbursimit”

Ministria ka dërguar dokumentet e vërtetimit të realizimit të kushtit global me shkresën 3367/2 për realizimin e kushtit për vitin 2016.

Dokumenti i INSTAT për indeksimin qershor 2016 mbi bazën e të cilit kanë dalë udhëzimet si më poshtë.

Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 17, datë 30.08.2016, “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pages për personat me aftësi te kufizuar", të ndryshuar.

Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 18, datë 30.08.2016, “Mbi zbatimin e vendimit Nr.277, datë 18.06.1997, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimin nga statusi i të verbërit" të ndryshuar.

Udhëzim i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 19, datë 30.08.2016, “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 31, datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar.

Gjatë vitit 2017 plotësimi i kushtit global për këtë vit vërtetohet me udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës si më poshtë:

Dokumenti i INSTAT për indeksimin dhe mbi bazën e te cilit kanë dalë udhëzimet.

Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 365, datë 21.09.2017, “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 31, datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" të ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 366, datë 21.09.2017, “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar" të ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 367, datë 21.09.2017 “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 277, datë 18.06.1997, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimin nga statusi i të verbrit" të ndryshuar.

Më 22 qershor Banka Botërore, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës të dorëzuar zyrtarisht nga MMSR, ka konfirmuar se të dyja ILD janë përmbushur dhe ka rekomanduar Ministrinë e Financave të procedoje me dërgimin e aplikimit të tërheqjes së transhit përkatës.

Me shkresën Nr 3462, date 22.06.2016 MMSR i ka dërguar Ministrit të Financave kërkesën për tërheqje të transhit të huas (të dhjetë dhe njëmbëdhjetë) për projektin “Modernizimi i asistencës sociale”.


Nga auditimi rezulton se deri në 31 Dhjetor të 2017 situata e përgjithshme e arritjes së indikatorëve DLI paraqitet si me poshtë:

Treguesi që lidhet me disbursimet (DLI)	Progresi i arritjes dhe disbursimit sipas DLI	Shuma ne euro e disbursuar	Shuma ne euro e pa disbursuar
DLI 1	Dibursuar ne Janar 2014	1,045,000	-
DLI 2	Disbursuar ne Dhjetor 2014	1,900,000	-
DLI 3	Disbursuar ne Dhjetor 2015	1,900,000	-
DLI 4	Nuk janë arritur ende	-	2,500,000
DLI 5	Disbursuar ne Dhjetor 2015	1,900,000	-
DLI 6	Disbursuar ne Qershor 2016	1,900,000	-
DLI 7	Korrik 2017	2,500,000	-
DLI 8	Disbursuar ne Maj 2014	2,090,000	-
DLI9	Disbursuar ne Dhjetor 2014	2,850,000	-
DLI 10	Disbursuar ne Maj 2014	2,850,000	
DLI 11	Nuk janë arritur ende		2,850,000
DLI 12	Nuk janë arritur ende		2,090,000
DLI 13	Disbursuar ne Qershor 2016	2,090,000	
DLI 14	Korrik 2017	2,850,000	
DLI 16	Nuk janë arritur ende		1,900,000
DLI 17	Nuk janë arritur ende		1,900,000
	Shuma	23,875,000	11,240,000
	Shuma totale	35,115,000	

Referuar tabelës sa më sipër bilanci i rezultateve të DLI të realizuara kundrejt totalit, paraqitet si më poshtë vijon:

Progresi	Nr i DLI	Shuma në euro DLI	% e DLI	Afati kohor
Pa arritur	5	11,240,000	31,25	1 vit
Të realizuar dhe disbursuar	11	23,875,000	68,75	4 vjet
TOTAL	16	35,115,000	100	5 vjet

Në mënyrë grafike ky rezultat paraqitet në vijim:



Gjetje 1.

Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2017 nga 22 aktivitete të parashikuara që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e indikatorëve DLI 4, 7, 11, 12 dhe 14, janë realizuar vetëm 8 aktivitete, 4 janë ende në proces, dhe 10 aktivitete të cilat kanë lidhje me realizimin e indikatorëve DLI 4,11,12, si dhe përfundimi i aktiviteteve për indikatorët DLI 16 dhe 17 mbeten për tu përmbushur gjatë vitit 2018.

Gjithashtu u konstatua se gjatë periudhës së auditimit me dokumentin nr.3195, datë 14.05.2018 është miratuar Urdhri nr.387, datë 14.05.2018 “ Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve të projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale për vitin 2018” ku në zbatim të tij ngarkohen strukturat e Z/Ministrit,Drejtoria e Zhvillimit të programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS, Ekipi i menaxhimit të Projektit dhe institucionet e vartësisë të MSHMS.

Rekomandim:

Nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit si dhe strukturat e angazhuara në realizimin e aktiviteteve, me qëllim realizimin e objektivave të projektit të modernizimit të asistencës sociale, për rrjedhojë realizimin e indikatorëve (realizimi i 5 DLI të pa realizuara), të ndiqet në mënyrë rigorozë zbatimi i planit vjetor të aktiviteteve të miratuar me urdhrin nr.387, datë 14.05.2018, duke përgatitur raporte progresive të ecurisë së këtij plani për titullarin, me synim mbikëqyrjen dhe marrjen e masave në kohë të eliminimit të risqeve të identifikuara gjatë zbatimit të tij dhe arritjen e realizimit të të gjithë aktiviteteve brenda afateve të programuara dhe vitit 2018, kjo dhe në kuadrin e një menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më eficient.

Menjëherë

Nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit në observacionin për rekomandimet e P/Raportit të paraqitur me shkresën nr. 2578/8, datë 27.07.2018 kanë cituar se kjo njësi asiston ministrinë në zbatimin e aktiviteteve teknike që lidhen me komponentin nr.2 kurse tek ministri raporton në mënyrë periodike lidhur me procedurat e prokurimit dhe financiare për realizimin e ketyre aktiviteteve.Realizimi i objektivave të projektit ndiqet dhe monitorohet nga strukturat pergjegjese ne ministri.

Sa më sipër japim këtë koment:

Mendojme që të dy llojet e raportimeve sipas kompetencave dhe funksioneve që lidhen me zbatimin e projektit të “Modernizimit të Asistencës Sociale” i shërben një qëllimi të vetëm, monitorimit dhe realizimit të suksesshëm të të gjithë elementeve përbërës të këtij projekti . Rekomandimi i lenë nga grupi i auditimit ka cilësuar pikërisht Njësinë e Projektit si dhe strukturat e ministrisë përgjegjëse për realizimin e objektivave të projektit për te bere raportime ne lidhje me realizimet përkatëse sipas kompetencave, por ne koherencë me njëra tjetrën, në mënyrë që ky projekt te mund te jete i suksesshem deri ne fund te vitit, që përcakton dhe afatim përfundimtar te tij.
Në këtë kënd vështrim observacioni nuk merret ne konsideratë

3. Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitin 2017 nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri.

Referuar përcaktimeve në marrëveshjen e huas të Ratifikuar me ligjin nr.84, datë 18.09.2012, të ndryshuar në “ Programin 2” “ Zbatimi i Projektit” Menaxhimi Financiar, raportet financiare dhe auditimet “ në pikën B.3 përcaktohet:

“ Huamarrësi auditon pasqyrat financiare që lidhen me projektin në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën nga këto periudha: i) i dorëzohet Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe; dhe ii) vihen në dispozicion të publikut në një kohë dhe mënyrë që është e pranueshme për Bankën”

Sa më sipër nga njësia e projektit “Modernizimi i asistencës sociale” janë përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2017.

Auditimi i këtyre pasqyrave u krye në zbatim të akteve ligjore sa më poshtë vijon:

-Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimet e Ministrisë së Financave si

- Udhëzimi nr. 14, date 28 .12 .2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe te njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj”, të ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007, udhëzimin nr.10, datë 27.02.2008,

-Udhëzimi nr.23 datë 22.12.2017 “Për procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te Buxhetit për vitin 2017”.

Nga ky auditim rezultoi :

1-Pasqyrat Financiare për periudhën 1 janar 2017 – 31 dhjetor 2017 për “ Projektin e modernizimit të asistencës sociale”, për komponentin 2, janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën 65, datë 28.03.2018, kundrejt afatit 15 Mars të përcaktuar në pikën 4 të udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006, të ndryshuar ku citohet:

“Njësite e menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj detyrohen te depozitojnë brenda datës 15.03.2007 një kopje te Pasqyrave Financiare pranë Ministrisë apo institucionit publik qe menaxhon projektin/organ i vartësisë, një kopje pranë donatorit/reve përkatës dhe, pas miratimit nga Degët përkatëse te Thesarit kur vepron me skemën e thesarit një kopje ne Drejtorinë e Kontabilitetit pranë Ministrisë se Financave”.

2-Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është bërë në përputhje me formatet dhe udhëzimet e përcaktuara nga Ministria e Financave sa më sipër cituar, ku përmendim disa veçori për llogarite vjetore te njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj si:

a-“Kostoja e ngritjes dhe funksionimit te njësise gjate periudhave ushtrimore ne fund te vitit, pasqyrohet ne grupin e llogarive 230 “Aktive te pa trupëzuara ne proces” me kunderparti llogarinë 782” Punime për investime ne ekonomi”.

b-“Ne përfundim te projektit, kur investimi dorëzohet i përfunduar tek institucionet përfituese, kostoja e administrimit të projektit kalon në koston e objektit të përfunduar”.

Aktualisht për vetë specifikat që ka Projekti i “ Modernizimit të asistencës sociale “ nga njësia e projektit janë mbajtur dhe hartuar pasqyrat financiare vetëm për komponentin 2 të projektit që janë “Shërbimet e konsulentëve në kuadër të pjesës së dytë të projektit dhe kostot operative” të cilat referuar marrëveshjes së ndryshuar janë në shumën 2.79 milionë Euro.

Pasqyrat financiare të hartuara për vitin 2017(plotësimi i formateve përbërës të pasqyrave financiare) paraqesin të dhënat për shpenzimet e vitit të mbyllur 2017 (1Janar- 31 dhjetor) dhe të vitit paraardhës 2016 (1 janar dh- 31 Dhjetor).

Këto pasqyra në plotësimin e formatit nr.1(aktivi) dhe nr.2(pasivi) në rubrikat përkatëse nuk kanë pasqyruar të dhëna progresive që nga fillimi i projektit , veprim që bie në kundërshtim me kapitullin IV. Paragrafi “Formati i llogarive vjetore te njësive te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj është i njëjte me atë qe miratohet me këtë udhëzim. Për përgatitjen e pasqyrave financiare ato zbatojnë te njëjtat procedura e kriteret te përcaktuara ne rubrikat përkatëse te këtij udhëzimi” si dhe Kapitullin III.”Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare te vitit..”

“1. Për Aktivin e Bilancit kontabël(Formati nr. 1)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet aktivitet te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.2.....).

2. Për pasivin e bilancit kontabël(Formati nr.2)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet pasivitet te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.....)”,

Sa më sipër cituam rezulton që në këto rubrika informacioni i paraqitur duhet të jetë progresiv.

3-Pasqyrat financiare janë shoqëruar me shënimet shpjeguese si dhe evidencat përkatëse, të kursit të këmbimit në fund të vitit, gjendjen në llogarinë e projektit në fund të vitit 2017, pasqyrën e disbursimeve dhe shpenzimeve në Euro dhe konvertuar në lekë me kursin e fund vitit të Bankës së Shqipërisë, raportin financiar sipas raportimit të pranuar nga banka.

4-Nga Njësia e Projektit na u vu në dispozicion Raporti i auditorit të pavarur të kontraktuar nga Ministria e Financave për vitin 2016 (pasi për vitin 2017 deri në periudhën e këtij auditimi nga KLSH, huamarrësi nuk ka njoftuar Njësinë e Projektit për kontraktimin e ndonjë audituesi të pavarur për ekspertimin e pasqyrave financiare të vitit 2017).

Nga Ministria e Financave (huamarrësi) është kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016 shoqëria X Sh.pk e cila më 24 Nëntor të vitit 2017 ka dhënë opinion e saj lidhur me pasqyrat financiare të periudhës 1Janar2016 - 31 Dhjetor të 2016.

Opinion i ekspertëve auditues të pavarur është se këto pasqyra financiare, në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit në sektorit Publik.

Nga audituesit e pavarur për pasqyrat financiare të vitit 2016, më 1 Dhjetor të vitit 2017 i janë drejtuar menaxhimit me dokumentin “Letër Menaxhimit të projektit “ Modernizimi i asistencës sociale”, në të cilin i shprehin opinionin dhe rekomandime për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm .

Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim rekomandimet e tyre :

1	Disbursime	250,000.00	149,137.72	281,205.04	227,059.41	370,451.36	1,277,853.53
2	Interesa	272.63	283.61	173.18	80.23	48.44	858.09
	Totali	250,272.63	149,421.33	281,378.22	227,139.64	370.499	1,278,711.62
3	Shpenzime	81,770.48	287,788.19	205,172.37	217,915.13	421,276.33	1,213,922.50
4	Komisione	183.76	677.55	466.04	425.31	608.75	2,361.41
	Totali i Shpenzimeve	81,954.24	288,465.74	205,638.41	218,340.44	421,885.08	1,216,283.91

Shifrat sa mësipër marrë nga raportet financiare të njësisë së projektit për BB këto referuar dhe raporteve të dërguara në MF.

Në këtë situacion progresiv të paraqitur në tabelën e mësipërme rezulton se vlera disbursimeve dhe shpenzimeve për vitin 2017 është më e lartë se ajo e viteve të tjera të marra veçmas si rezultat edhe i shtrirjes së skemës së pilotimit të NE në pothuajse të gjithë territorin e vendit dhe ku shpenzimet për asistencë dhe veprimtari të aktiviteteve kanë qenë më të shumta. Gjithashtu theksojmë se për vitin 2018, që korrespondon dhe me përfundimin e projektit (31 dhjetor 2018) shuma e shpenzimeve të padisbursuara është e lartë, gjë që vënë përball një detyrimi për programim konciz të të gjitha aktiviteteve dhe shpenzimeve për këtë vit për arritjen e objektivave të programuar dhe të suksesshëm të projektit.

Për Komponenti 1 të Projektit:

Mbështetur në MOP (Manualin Operacional të Projektit), Njësia e Menaxhimit të projektit përfshin në Raportet e Progresit të Projektit (periodike) si aneks të veçantë raportimin mbi realizimin e Programit Ndhim Ekonomike (NE) dhe Pagesa të Aftësisë së Kufizuar (PAK). Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë janë marrë të dhënat zyrtarisht nga sistemi i thesarit lidhur me realizimin e fondeve buxhetore për programin e mbrojtjes sociale për vitin 2017.

Nga të dhënat e marra nga Ministria e Financës për vitin 2017, transfertat për buxhetet familjare dhe individët të kryera për pagesat e NE janë bërë nga 61 Njësi të Qeverisjes Vendore (Bashki) dhe janë në vlerën (Cash) 4,819,335.56 mijë lekë për ndihmën ekonomike dhe 15,744,63.12 mijë lekë për pagesat e aftësisë së kufizuar, në total 20,563,398.68 mijë lekë (cash), kundrejt fondeve të çelura në buxhetin e shtetit me aktet ligjore për vitin 2017, në shumën 20,683,960.89 mijë lekë nën programin “mbështetja sociale”, ku 4,919,408.53 mijë lekë çelur për NE dhe 15,764,552.36 mijë lekë çelur për Pagesat e Aftësisë së Kufizuar.

Referuar citimeve në Marrëveshje, tërheqjet nga Huamarrësi për kategorinë 1, do të bëhen me kërkesë të tij, ku për secilin trash do të jenë në përputhje me shumën e treguesve të lidhur me disbursimet, dhe realizimin e çdo indikatorit, të specifikuar në tabelën e shtojcës 2, të marrëveshjes, në varësi të raporteve të paraqitura në Bankë të evidencave të pranueshme për bankën dhe sipas përcaktime të bëra në manualin operacional të projektit.

Aktualisht për vitin 2017, disbursimet nën komponentin 1, janë bërë sipas kërkesës për disbursime pasi është verifikuar nga BB :

- (i) arritja dhe përputhshmëria e indikatorëve lidhur me disbursimet (ILD)
- (ii) Programi i Shpenzimeve të Ligjshme që ka disbursuar fonde të mjaftueshme për të mbuluar disbursimin.
- (iii) Verifikimit të Kushtit Global të Disbursimit se mbajtja e indeksimit të inflacionit për përfitimet nga paaftësia është arritur; *dhe*

(iv) BB do të disbursojë shumën e shpenzimeve të ligjshme të shkaktuara nga përmbushja e Indikatorëve Lidhur me Disbursimet.

Në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara për (i),(iii),(iv) sa më sipër cituam, janë trajtuar gjerësisht në pikën dy të drejtimeve të auditimit që ka të bëjë me Menaxhimin Financiar dhe disbursimet financiare të fondeve të projektit si dhe shkallën e realizimit të DLI.

Për plotësimin e kushtit (ii) "Programi i Shpenzimeve të Ligjshme ka disbursuar fonde të mjaftueshme për të mbuluar disbursimin" nga auditimi është konstatuar:

Për vitin 2017, janë tërhequr 2 transhe nga kredia në shumën 5,350,000 Euro pjesë e realizimit të kategorisë 1, nga shumën totale 35,115,000 Euro dhe një nga kushtet që duhet të plotësojë Qeveria Shqiptare për disbursimin e transheve sa më sipër cituam është plotësimi i kushtit të përcaktuar në pikën A 5 të Programit 2 "Zbatimi i projektit" në të cilin theksohet se: "Huamarrësi garanton që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit, fondet e nevojshme buxhetore të vihen çdo vit në dispozicion për qëllimet e zbatimit të projektit.

Referuar raportit të monitorimit për vitin 2017 të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nën programin "Përkujdesi social", janë kërkuar fonde në procesin e hartimit të PBA për vitin 2017, për shpenzime në artikullin "606" Transferta për buxhete familjare dhe individë" në shumën 20,500,000 mijë lekë, kundrejt 20,025,512 mijë lekë të realizuar në vitin 2016.

Aktualisht për vitin 2017 në bazë të ligjit 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, fondet e çelura për programin "Përkujdesi social" kanë qenë në shumën 20,758,967 mijë lekë dhe të realizuara në masën 20,713,254 mijë lekë.

Në këtë program ndër produktet e rëndësishme të tij, janë Ndhima Ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar.

-Në vitin 2017, referuar Raporteve të Monitorimit të publikuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për pagesën e personave me aftësi të kufizuar është vënë në dispozicion fondi prej 15,764,552.36 mijë lekë (kurse sipas raportimit të thesarit është shpenzuar shuma **15,744,063.12 mijë lekë**) **ku janë trajtuar 139,259 persona, nga 160,000 persona të planifikuar** nga Ministria në Projekt Buxhetin Afatmesëm, referuar kërkesave të planifikuara të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore.

Për Ndhimën Ekonomike për vitin 2017, numri i familjeve që kanë përfituar pagesën e ndihmës ekonomike rezulton të jetë **81,198 familje**, për të cilat është shpenzuar fondi në total **4,819,335.56 mijë lekë** që përfaqësojnë shumën direkt në llogaritë e familjeve në nevojë nga **78.000 familje të planifikuar** nga ministria me fond të çelur në shumën 4,919,408.53 mijë lekë. Referuar auditimeve të kryera në 4 bashki dhe njësi administrative rezultoi se në këto njësi vendore janë realizuar 100% nevojat për fondet e NE dhe nuk kanë rezultuar detyrime të pashlyera të vitit 2017 në fundin e vitit Nga krahasimi i dokumentacionit të mbajtur gjatë procesit të rakordimit si për fondet e çelura ashtu dhe për fondet e përdorura midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, Njësitë të Pushteti Vendor, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Buxhetit nuk rezultoi që të kishte diferenca si për fondet e planifikuara ashtu dhe për ato të realizuara, të raportuara nga Njësia e Projektit në Raportet Financiare për Bankën Botërore.

Gjetje 1.

Nga auditimi ka rezultuar se Pasqyrat financiare të hartuara për vitin 2017(plotësimi i formateve përbërës të pasqyrave financiare) paraqesin të dhënat për shpenzimet e vitit të mbyllur 2017 (1Janar- 31 dhjetor) dhe të vitit paraardhës 2016 (1 janar dh- 31 Dhjetor).

Këto pasqyra në plotësimin e formatit nr.1(aktivi) dhe nr.2(pasivi) në rubrikat përkatëse nuk kanë pasqyruar të dhëna progresive që nga fillimi i projektit, veprim që bie në kundërshtim me kapitullin IV dhe Kapitullin III të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, date 28 .12 .2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe te njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj”, të ndryshuar, përkatësisht paragrafët ku citohet:

“Formati i llogarive vjetore te njësive te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj është i njëjte me atë qe miratohet me këtë udhëzim. Për përgatitjen e pasqyrave financiare ato zbatojnë te njëjtat procedura e kritere te përcaktuara ne rubrikat përkatëse te këtij udhëzimi”, si dhe

”Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare te vitit..”

“1. Për Aktivin e Bilancit kontabël (Formati nr. 1)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet aktivitet te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.2.....).

2. Për pasivin e bilancit kontabël(Formati nr.2)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet pasivitet te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.....)”, paragrafë që domosdoshmërisht kërkojnë të dhëna progresive.

Niveli i prioritetit: i mesëm

Rekomandim 1

-Nga Njësia e Zbatimit të Projektit të përgatiten pasqyrat financiare(formatet përkatës) me të dhënat progresive nga fillimi i projektit deri në fund të vitit 2017, në zbatim të procedurave të paraqitura në udhëzimet e miratuara nga Ministria e Financave.

Menjëherë

- Nga Njësia e Zbatimit të Projektit, Pasqyrat Financiare progresive deri në fund të vitit 2017, të jenë baza për përgatitjen e Pasqyrave Financiare të vitit 2018 dhe përfundimit të projektit, duke qenë se “Projekti i Modernizimit të asistencës sociale” e ka afatin e përfundimit 31.12.2018.

Në vazhdim

4. Mbi auditimin e transaksioneve financiare të pagesave dhe vlerat e raportuara nën Programin e Ndhmës Ekonomike dhe Asistencës Sociale

Për auditimin e transaksioneve të NE dhe PAK nga grupi i auditimit është përcaktuar numri i transaksioneve referuar materialitetit dhe riskut. Gjithashtu për verifikimin e transaksioneve u përzgjedhën bashki të pa audituara për NE nga KLSH më parë (Bashkia Shkodër dhe Bashkia e Malësisë së Madhe) si dhe dy njësitë pilot për PAK në Tiranë.

(Njësia nr.6 dhe njësia nr.7). Në këto njësi bashkiake u kontrollua baza ligjore që përcakton kriteret dhe procedurat e masës së ndihmës ekonomike, dosjet e personave që kanë aplikuar për ndihmë sociale në zyrën e ndihmës ekonomike në bashki si dhe vendimet e bashkisë për përfituesit e ndihmës ekonomike, borderotë e ndihmës ekonomike, situacionet etj

Vendimet nga Këshillat Bashkiakë për propozimin për dhënie ndihme ekonomike përfshijnë familje për ndihmë ekonomike, individë me statusin e jetimit, individë viktime të trafikimit, individë viktime të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, katërnjakë, pesënjakë etj. Në këto vendime përcaktohen edhe familjet të cilat nuk përfitojnë ndihmë ekonomike me arsyet e daljes nga skema.

Për njësitë administrative nr. 6 dhe nr. 7, Tiranë:

Mbështetur në ligjin nr. 9355, dt. 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe vendimin nr. 904, dt. 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe

procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot”, si dhe në bazë të projekt vendimeve të paraqitura nga administratorët shoqërorë, këshilli bashkiak i Bashkisë Tiranë i ka propozuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë numrin e personave të aplikuar për përfitim ndihme ekonomike periudhave mujore. Referuar Vendimit të SHSSH dhe mbi bazën e tij , vendimit të Këshillit Bashkiak janë hartuar listë pagesat sipas listave emërore të përfituesve për 12 muajt e vitit 2017 brenda vitit korrent.

Për Njësinë Administrative nr.6 është dhënë ndihmë për 396 familje dhe individë me statusin e jetimit, individë viktimë të trafikimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, katërnjakë, pesënjakë etj.. Nga këto 312 familje janë trajtuar me ndihmë ekonomike, ku 75 janë familje që kanë në përbërjen e tyre persona me PAK, 55 janë familje që kanë në përbërjen e tyre nga komuniteti Rom dhe 104 janë familje që kanë në përbërjen e tyre kryefamiljare gra. Individë me statusin e jetimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, fëmijë normal me shërbim kujdestarie janë trajtuar gjithsej 84 raste. Nga këto familje në skemë kanë përfituar kompensim energjie 47 prej tyre. Për Njësinë Administrative nr. 7 është dhënë ndihmë për 132 familje. Nga këto 112 familje janë trajtuar me ndihmë ekonomike dhe Individë me statusin e jetimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, fëmijë normal me shërbim kujdestarie janë trajtuar gjithsej 20 raste. Nga këto familje në skemë kanë përfituar kompensim energjie 14 prej tyre.

Gjithashtu janë përcaktuar edhe familjet e propozuara të cilat nuk përfitojnë ndihmë ekonomike të refuzuara nga sistemi. Për Njësinë Administrative nr. 6 janë gjithsej 2 familje dhe për Njësinë Administrative nr. 7 janë gjithsej 7 familje.

Kryesisht arsyet e daljes nga skema janë individë të punësuar, të zhvendosur dhe “nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme”, etj.

Nga auditimi në Bashkinë e Malësisë e Madhe

Për vitin 2017 nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Malësisë së Madhe janë miratuar 12 vendime për propozimin për dhënie ndihme ekonomike. Për Bashkinë Malësi e Madhe është dhënë ndihmë për 2180 familje dhe individë me statusin e jetimit, individë viktimë të trafikimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, katërnjakë, pesënjakë etj.. Nga këto 374 familje janë trajtuar me ndihmë të plotë, dhe 1806 familje janë trajtuar me ndihmë të pjesshme. Nga këto 114 janë familje që kanë në përbërjen e tyre persona me PAK dhe 364 janë familje që kanë në përbërjen e tyre kryefamiljare gra. Individë me statusin e jetimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, fëmijë normal me shërbim kujdestarie janë trajtuar gjithsej 5 raste. Nga këto familje në skemë kanë përfituar kompensim energjie 102 prej tyre.

Gjithashtu janë përcaktuar edhe familjet e propozuara të cilat nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe që janë të refuzuara. Mesatarisht nga skema e ndihmës ekonomike hyjnë dhe dalin rreth 6 familje për çdo muaj.

Nga auditimi në Bashkinë Shkodër

Për vitin 2017 nga Këshilli bashkiak i Bashkisë Shkodër janë miratuar 12 vendime për propozimin për dhënie ndihme ekonomike. Nga Bashkinë Shkodër është dhënë ndihmë për 3433 familje dhe individë me statusin e jetimit, individë viktimë të trafikimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, katërnjakë, pesënjakë etj.. Nga këto 982 familje janë trajtuar me ndihmë të plotë, dhe 2451 familje janë trajtuar me ndihmë të pjesshme. Nga këto 360 janë familje që kanë në përbërjen e tyre persona me PAK, 140 janë familje që kanë në përbërjen e tyre nga komuniteti Rom dhe 193 janë familje që kanë në përbërjen e tyre kryefamiljare gra. Individë me statusin e jetimit, individë viktimë të dhunës në familje, individë prindër të fëmijëve të lindur trinjakë, fëmijë

normal me shërbim kujdestarie janë trajtuar gjithsej 40 raste. Nga këto familje në skemë kanë përfituar kompensim energjie 614 prej tyre.

Gjithashtu janë përcaktuar edhe familjet e propozuara të cilat nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe që janë të refuzuara. Mesatarisht nga skema e ndihmës ekonomike hyjnë dhe dalin rreth 60 familje për çdo muaj.

Nga auditimi i njësive të qeverisjes vendore sa më sipër rezultoi se:

-Fondet për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar për vitin 2017 janë likuiduar brenda vitit 2017.

-Fondet buxhetore të çelura kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimmarrjet për pagesat e PAK dhe NE.

- Vendimet e Këshillave Bashkiakë për Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Malësi e Madhe shpesh herë janë pas datës 20 të muajit përkatës, veprim që bie në kundërshtim me vendimin nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar , pika 6. “Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit projektvendimin për familjet/individët që kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike, në bazë të të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror dhe e paraqet për miratim pranë këshillit bashkiak, i cili brenda datës 20 të çdo muaji merr vendimin për propozim për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe ia përcjell Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror”. Udhëzimi në fuqi për zbatimin e këtij vendimi ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2017.

Nga verifikimi i transaksioneve nëpërmjet thesarit dhe respektivisht në llogaritë e çelura në bankat e nivelit të dytë dhe Postën Shqiptare, për përfituesit, si dhe rakordimet përkatëse midis njësisë së qeverisjes vendore , degëve të thesarit në rrethet përkatëse, konfirmimeve të Postës Shqiptare në qarkun përkatës dhe Bankave të nivelit të dytë rezultoi se nuk u paraqitën diferenca nga fondet e çelura dhe miratuara me urdhër shpenzimet sipas listë pagesave. Tabelat me të dhënat përkatëse për këtë rakordim janë vendosur bashkëlidhur këtij Projektraporti në Aneksin nr.3.

4/1 Çështje të tjera lidhur me zbatimin e Projektit NE dhe PAK

Grupi i auditimit gjatë verifikimit në terren të transaksioneve të Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave të Aftësisë së Kufizuar konstatoi disa problematika, të cilat janë të nevojshme të ndiqen dhe zbatohen nga palët, pjesë e procesit dhe për një zbatim më efektiv dhe të unifikuar të tyre, kërkojnë përcaktime dhe rregullime procedurale konkrete në udhëzimet në fuqi.

Këto konstatime ndonëse nuk janë të të njëjtës natyrë dhe kompetenca e zbatimit mund të jetë e institucioneve pjesë e këtij procesi, nga grupi i auditimit po i vihen në dukje njësisë së projektit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucion zbatues i projektit dhe si lidër në procesin e modernizimit të asistencës sociale.

A. Në lidhje me afatin çeljes së fondeve nga institucionet përkatëse deri në kohën kur këto fonde vihen në dispozicion tek përfituesit.

a-Në udhëzimin nr. 4 datë 11.03.2014 “Për planifikimin e fondeve për NE”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr.3, datë 10.03.2014 “ Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” të ndryshuar jepet mënyra si si planifikohen fondet për NE dhe PAK si dhe afatet kohore të dërgimit të këtyre kërkesave nga SHSSH referuar evidencave të ardhura nga NQV janë datat deri në 10 shkurt, prill, qershor, gusht tetor për dymujorët pasardhës.

Aktualisht për vitin 2017 nuk janë respektuar këto afate nga SHSSH dhe këtë e tregojnë çeljet buxhetore për NJQV si më poshtë vijon: ***për Ndihmën Ekonomike***

Shkresat e shërbimit Social për celje	Kërkesa janar - shkurt me email me date 19,12,2016	Kërkesa mars - prillit me shkresën nr 162/9 date 22,02,2017	Ministria	Ministria	Ministria	Ministria
Emer Institucionit	Shkresa e Ministrise Nr 7723/4 datë 20,01,2017, shkresa nr 162/3 date 26,01,2017, Drejtorive Rajonale	Me email-date 02,03,2017, shkresa nr 162/12 date 07,03,2017 Drejtorive Rajonale	Shkresa e Ministrise Nr 642 datë 31,01,2017	Shkresa e Ministrise Nr 108,7 datë 17,02,2017 Per dijeni	Shkresa e Ministrise Nr 1471 datë 03,03,2017. Per dijeni	Shkresa e Ministrise Nr 1471 datë 03,03,2017, Per dijeni
Shuma	952.000.000	886.849.750	9.043.620	6.432.597	8.395.044	6.504.200

Kërkesa maj - qershori me shkresën nr 799, date 20,04,2017	Kërkesa korrik gushti me shkresën nr 162/27 date 15,06,2017	Kërkesa shtator - tetiri me shkresën nr 162/32 date 15,08,2017	Ministria	Ministria	Kërkesa Nentor Dhjetorit me shkresën nr 162/46 date 20,10,2017	me vendim ministria	
Me email-date 27,04,2017, shkresa nr 162/20 date 02,05,2017, Drejtorive rajonale	Me email-date 23,06,2017, shkresa nr 162/30 date 27,06,2017 drejtorive rajonale	Me email-date 11,09,2017 shkresa nr 162/37 date 13,09,2017 Drejtorive rajonale	1611/1, date 10,03,2017, Per dijeni	Me email-date 11,09,2017, Per dijeni	Shkresa e Ministrise Nr 4384/1 datë 24,10,2017, shkresa nr 162/50, date 01,11,2017 Drejtorive Rajonale	Shkresa e Ministrise Nr 19128/1 datë 29,12,2017 Shkresa nr 38, date 09,01,2018 Akti normativ shpërblimet	Fondet e Ndhimes Ekonomike ne Mbyllje, 2017
781.332.000	789.064.000	633.016.983	5.792.615	10.931.750	722.022.000	158.778.000	4.970.162.559

Për PAK çelja e fondeve për NJQV është bërë sipas shkresave dhe afateve si më poshtë vijon:

Shkresat e shërbimit Social për celje	Kërkesa janar - shkurt me email me date 19,12,2016	Kërkesa mars - prillit me shkresën nr 162/9 date 22,02,2017	Ministria	Kërkesa maj - qershori me shkresën nr 799, date 20,04,2017	Kërkesa korrik gushti me shkresën nr 162/27 date 15,06,2017
--	--	---	-----------	--	---

Emer Institucionit	Shkresa e Ministrise Nr.7723/4 datë 20.01.2017, shkresa nr 162/3 date 26.01.2017, Drejtorive Rajonale	Me email-date 02.03.2017, shkresa nr 162/12 date 07.03.2017 Drejtorive Rajonale	Shkresa e Ministrise Nr 642 datë 31.01.2017	Me email-date 27.04.2017, shkresa nr 162/20 date 02.05.2017, Drejtorive rajonale	Me email-date 23.06.2017, shkresa nr 162/30 date 27.06.2017 drejtorive rajonale
Shuma	2.668.720.000	2.716.121.200	22.685.079	2.609.449.000	2.613.440.000

Kerkesa shtator - tetiri me shkresen nr 162/32 date 15.08.2017	Ministria	Ministria	Kerkesa Nentor Dhjetorit me shkresen nr 162/46 date 20.10.2017	me vendim ministria	
Me email-date 11.09.2017, shkresa nr 162/37 date 13.09.2017 Drejtorive rajonale	Me email-date 12.09.2017, per dijjeni	Me email-date 12.09.2017, per dijjeni	Shkresa e Ministrise Nr 4384/1 datë 24.10.2017 shkresa nr 162/50, date 01.11.2017 Drejtorive Rajonale	Shkresa e Ministrise Nr 19128/1 datë 29.12.2017, Shkresa nr 38, date 09.01.2018 Akti normativ shperblimet	Totali Mbyllje ne PAK, 2017
2.503.394.238	26.600.000	-	2.492.205.924	134.622.000	15.787.237.441

b-Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE”, të ndryshuar në pikën 6 të tij citohet: “Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit projektvendimin për familjet/individët që kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike, në bazë të të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror dhe e paraqet për miratim pranë këshillit bashkiak, i cili brenda datës 20 të çdo muaji merr vendimin për propozim për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe ia përcjell Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror” dhe në pikën 7 citohet “Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga këshilli bashkiak, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë, gjeneron vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike” pa dhënë afat për këtë strukturë se deri me ç’datë duhet të nxjerrë vendimin e përfituesve nga sistemi elektronik i pikëzimit të NE

- Gjithashtu në pikën 9/b të vendimit citohet : Përfituesit të NE i hiqet ndihma ekonomike për 6 muaj NQS “ nuk tërheq ndihmën ekonomike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi”, pa shpjeguar se cilat duhet të jenë veprimet e punonjësve social dhe në një kohë që nuk ka një afat të përcaktuar deri kur duhet të dalin listë pagesat. Gjatë vitit 2017 referuar auditimit të transaksioneve në Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Njësi administrative 7 dhe 6 në Tiranë referuar urdhër shpenzimeve për kalimet nëpërmjet thesarit të pagesave për NE dhe PAK ka rezultuar se fondet përkatëse të tyre, në shumë raste, kanë kaluar në llogaritë e përfituesve në fund të muajit pasardhës dhe disa herë duke tejkaluar dhe afatin e muajit pasardhës (referuar urdhër shpenzimeve të cituara në tabelat e transaksioneve bashkëlidhur projekt raportit në aneksin nr.3), pra nuk ka një afat fikse të përcaktuar të daljes së urdhër shpenzimeve kështu e bën përfituesin të pa orientuar me ditën e daljes së NE dhe respektimin e datës së tërheqjes deri në 10 ditë nga data e publikimit.

Gjithashtu gjatë auditimit në subjektet sa më sipër audituar, ka rezultuar se dhe vendimet e bashkisë kanë tejkaluar në shumë raste afatin deri me datën 20 të muajit, për të nxjerrë vendimin me propozimin për përfituesit e Ndihmës Ekonomike. Citojmë se pavarësisht se VKM nr. 955, datë 7.12.2016 hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2018 për arsyet e implementimit të formulës së pikëzimit në gjithë vendin, çështja e afateve të përfitimit të fondeve duhej të ishte në qendër të vëmendjes nga të gjithë institucionet kur flitet për shtresat ekstremisht në nevojë dhe kur vetë VKM mban datën e daljes 7.12.2016.

- Gjatë auditimit në bashkinë e Malësi e Madhe , Bashkinë Shkodër, Njësinë Administrative 6 dhe 7 në Tiranë , vendimet e Këshillave Bashkiakë për përfituesit e Ndihmës Ekonomike dhe PAK referuar listës së përfituesve dhe fondeve përkatëse, dërgohen në Institucionin e Prefektit të Qarkut për të marrë konfirmimin ligjor në zbatim të nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”. Këto afate të hyrjes në fuqi si dhe marrja e miratimit të ligjshmerisë nga Institucioni i Prefektit të qarkut kanë vonuar për procedurë procesin e dhënies së shpërblimit përfituesve të NE dhe PAK (kjo e vërtetuar me dokumentacionin e marrë nga bashkitë e audituar sa më sipër). Hyrja në fuqi mbas 10 ditësh të vendimeve të KB si dhe konfirmimi i ligjshmerisë nga institucioni i Prefektit të Qarkut, në një kohë që NE përfitohet sipas formulës së sistemit të pikëzimit si dhe PAK përfitohet nga vendimet e Komisioneve apo Kempeve Eprore (si për njësitë pilot ashtu dhe për njësitë e tjera të qeverisjes vendore) në një kohë që flitet për fonde buxhetore për funksione të deleguara, ka vonuar procesin e dhënies së shpërblimit si të përfituesve të NE ashtu dhe përfituesve të PAK.

Gjetje 1

Nga autitmi i transaksioneve, që nga çelja e fondeve buxhetore nga SHSSH, dalja e vendimeve të Këshillave Bashkiakë dhe miratimi i afateve të hyrjes së fuqi të tyre, konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut deri tek miratimi i listës së përfituesve të NE dhe PAK dhe për rrjedhojë kryerja e pagesave përfituesve, ka rezultuar se ka vonesa referuar afateve të çeljes së fondeve buxhetore nga SHSSH dhe daljes së VKB, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 4 datë 11.03.2014 “Për planifikimin e fondeve për NE”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr.3, datë 10.03.2014 “ Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” të ndryshuar si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE”, të ndryshuar. Gjithashtu referuar procedurave të ndjekura me aktet ligjore të miratuara dhe udhëzimet për zbatim të tyre në fuqi, rezultoi se nuk ka të përcaktuar afat kohor maksimal të daljes së listës së përfituesve nga sistemi me formulë pikëzimi nga

SHSSH si dhe nuk ka afat maksimal të miratimit të urdhër shpenzimeve nga NJQV për pagesat e NE dhe PAK. Gjithashtu u konstatua se NJQV marrin konfirmimin ligjor nga Prefekti i Qarkut referuar nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, për vendimin e Këshillit Bashkiak për numrin e përfituesve dhe fondet respektive (miratim që vonon procesin dhe rezulton i pa dobishëm kur miratimi i listës së përfituesve realizohet nga sistemi me formulë pikëzimi për NE dhe nga komisioni apo kempit epror për përfituesit e PAK dhe fondet janë fonde buxhetore për funksione të deleguara.

Niveli i prioritetit: i mesëm

Rekomandim 1

a-Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një menaxhim sa më të mirë të afatit kohor mujor për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, në udhëzimet për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave për Pagesat e Aftësisë së Kufizuar dhe Ndihmës Ekonomike të përcaktohen afatet për çdo proces dhe Institucion (SHSSH dhe NJQV) dhe kryesisht për vendimin e SHSSH të listës së përfituesve të NE dhe PAK (njësitë pilot) dhe afatin maksimal të miratimit të urdhër shpenzimit të pagesave për këto kategori nga NJQV, afate të papërcaktuara në aktet dhe udhëzimet në fuqi.

Me shkresën nr.2578/8, datë 27.07.2018 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë observacion në lidhje me rekomandimin duke cilësuar se afatet kohore për planifikimin dhe delegimin e fondeve për pagesat e NE dhe PAK janë të përcaktuara në udhëzimin 8 datë 25.02.2015 dhe në udhëzimin nr. 3 datë 10.03.2014. Për këtë japim këtë opinion.

Nga grupi i auditimit është cilësuar në material se janë të përcaktuara këto afate që nga ana e ministrisë paraqiten si koment, duke cilësuar dhe faktin se megjithëse janë të përcaktuara në udhëzimet përkatëse përsëri ka vonesa gjatë procesit. Grupi i auditimit ka lënë rekomandim për tu mbuluar me afate të përcaktuara ato procese për ato institucione të cilat janë të pa mbuluara me afate kohore, kjo për efekt që çdo institucion dhe çdo strukturë e angazhuar në këtë proces të kryejnë në kohë pa vonuar procesin e tyre dhe pagesat e NE dhe të PAK të jenë në llogaritë e përfituesve brenda një kohe të shkurtër dhe jo siç ka ndodhur realisht mbas afërsisht një muaji nga muaji i aplikimit apo përfitimit. Gjithashtu kjo dhe për efekt të transparencës, që përfituesit të dinë afërsisht afatin e marrjes së të ardhurave që përfitojnë. Në këtë kontekst observacioni i juaj nuk merret në konsideratë.

b-Nga MSHMS në aktet sa më sipër cituam të përcaktohet dhe fakti se për këto pagesa, referuar legjislacionit në fuqi për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE dhe PAK, si dhe fondeve buxhetore për këto pagesa të cilat jepen nga institucionet qendrore, marrja e konfirmimit nga Institucioni i Prefektit për ligjshmërinë e numrit dhe pagesës për përfituesit e NE dhe PAK, del jashtë kompetencës së këtij institucioni.

Menjëherë

Me shkresën nr.2578/8, datë 27.07.2018 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është bërë observacion në lidhje me rekomandimin që marrja e miratimit nga Institucioni i Prefektit për ligjshmërinë e numrit dhe pagesës për përfituesit e NE dhe PAK, del jashtë kompetencës së këtij institucioni duke theksuar se vazhdon të jetë në kompetencë nr. i përfituesve të NE për 6 % e NE dhe për energjinë elektrike që përfitojnë këto kategori.

Sa më sipër citojmë se grupi i auditimit nuk ka përmendur këto pagesa që ju citoni në observacion, por pagesat që përfitohet NE nga sistemi dhe PAK nga komisionet mjekësore, ku në këtë proces është përcaktuar dhe fondi i përfituar. Duke pasur parasysh se miratimi nga zyra e prefektit e vonon procesin dhe është formal (pretendim i nxjerrë dhe nga zyrat e NE

dhe PAK në NJQV) mundësisht të hiqet si procedurë. Kurse 6% i ndihmës ekonomike që u i është lënë kompetencë NQV si dhe përfitimi i energjisë elektrike behet me të tjera list pagesa dhe tjetër procedurë (me vendimmarrje të NJQV), kështu që këto pagesa kanë nevojë për konfirmimin e ligjshmërisë nga prefekti i qarkut.

Sa më sipër trajtuam komenti juaj nuk merret në konsideratë

B. Mbi procesin e auditimit të mbajtjes së dokumentacionit të përfituesve të NE në Bashki dhe njësi administrative.

-Nga grupi i auditimit në Bashkitë dhe Njësitë e audituara përveç të tjerave të trajtuara më gjerësisht në drejtimin e auditimit nr. 4 “Mbi auditimin e transaksioneve financiare të pagesave dhe vlerat e raportuara nën Programin e Ndihmës Ekonomike dhe Asistencës Sociale” u krye dhe auditimi i realizimit të vizitave në familjet që kishin përfituar NE nga administratorët shoqërorë, nga ku rezultoi se në Bashkinë Malësi e Madhe, në dosjet e audituara ishte prezent dokumenti sipas formularëve të miratuar, i verifikimit social – ekonomik i familjeve në nevojë, vetëm për një herë në vit dhe ky dokument i konfirmuar nga Administratori Shoqëror, kurse në njësinë administrative nr. 6 në Tiranë, në dosjet e audituara rezultoi se ishte prezent në dosje ky dokument për vizitë në familje vetëm një herë, por ky dokument ishte i pakonfirmuar nga Administratori Shoqëror dhe përfituesit e NE, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e vendimit të KM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriterëve, procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike” vendim që aktualisht ka hyrë në fuqi me botimin në fletoren zyrtare, në të cilin cilësohet se gjatë vitit administratorët shoqërorë verifikojnë situatën Social Ekonomike të familjeve në nevojë dy herë në vit.

-Gjithashtu gjatë auditimit në Bashkitë Malësi e Madhe si dhe Bashkia Shkodër, në të cilat aplikimi sipas sistemit të formulës së pikëzimit ka filluar në zbatohet gjatë vitit 2018, ka rezultuar se shpesh herë kanë hasur vështirësi në plotësimin e disa rubrikave të formularëve të miratuar të aplikimit si dhe të vizitave në familje (kur rezultonte mall i falur apo i blerë pas deklarimit në aplikimin e parë dhe për këtë rast familja penalizohej me deklarim të remë, etj), kjo si pasojë dhe trajnimin jo me shembuj konkretë, por shumë teorik të realizuar, pra i pa mjaftueshëm për gamën e gjerë të problematikave të rezultuara hap pas hapi (pretendimi i Bashkisë Shkodër dërguar zyrtarisht grupit të auditimit të KLSH). Gjithashtu referuar problematikës së paraqitur (rastet e eliminimit nga skema të jetimëve, në një kohë që këto janë kategori që nuk futen në formulën e pikëzimit, por janë përfitues direkt, kundrejt dokumentacionit ligjor që vërteton statusin e jetimit, tregon se administratorët shoqërorë, me shtrirjen mbarë kombëtare të sistemit të vlerësimit të NE me formulë pikëzimi kanë nevojë për mbikëqyrje dhe asistencë të vazhdueshme.

- Nga SHSSH grupit të auditimit ju dërguan struktura organizative e njësisive të qeverisjes vendore, të cilët mbulojnë detyrat funksionale të Administratorëve shoqërorë në këto njësi. Nga shqyrtimi i këtyre strukturave rezultoi se shumë NJQV nuk kanë strukturat e duhura në njerëz dhe shpesh herë këto detyra mbuloohen nga zyrat e financës së njësisive të qeverisjes vendore, gjë që e bën të pamundur zbatimin e procedurave konform vendimit të KM nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriterëve , procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike”, të ndryshuar dhe vendimin e KM nr. 956, datë 7.12.2016 “ Për përcaktimin e Kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike ”.

Më poshtë po paraqesim mënyrën e organizimit të atyre qarqeve që bashkitë e tyre paraqiten me probleme:

Qarku	Bashkia	Struktura që mbulon funksionet	që mbulon e	Fondet buxhet. të vitit 2017
-------	---------	--------------------------------	-------------	------------------------------

		Administratorëve Shoqëror	(buxhetimi) në 000/lekë
Qarku Elbasan	Bashkia Përrenjas	Drejtoria e financave dhe zhvillim sektor vetëm me njeri	211,147.76
Qarku Fier	Bashkia Roskovec	Drejtoria e financave dhe zhvillim sektor vetëm me një njeri	4,580.34
Qarku Fier	Bashkia Divjake	Drejtoria e financave dhe zhvillim sektor vetëm me një njeri	2,009.20
Qarku Shkodër	Bashkia Puke	<i>S'ka informacion</i>	45,890.91
Qarku Shkodër	Bashkia Fushe Arrës	<i>S'ka informacion</i>	43,706.39
Qarku Shkodër	Bashkia Vau i Dejës	<i>S'ka informacion</i>	76,715.05
Qarku Gjirokastrë	Bashkia Memaliaj	<i>S'ka informacion</i>	23,930.36
Qarku Gjirokastrë	Bashkia Përmet	<i>S'ka informacion</i>	9,824.47
Qarku Gjirokastrë	Bashkia Këlcyre	<i>S'ka informacion</i>	8,894.01
Qarku Gjirokastrë	Bashkia Libohovë	<i>S'ka informacion</i>	609.90
Qarku Tiranë	Bashkia Kavajë	<i>Përgjegjës sektori</i>	71,035.92
Qarku Tiranë	Bashkia Rrogozhinë	<i>Nuk ka strukture</i>	26,333.34

-Gjatë auditimit me zgjedhje në njësinë administrative nr. 7 rezultuan disa raste ku përfituesit e ndihmës ekonomike të cilët marrin vërtetim në shkollë për fëmijët e tyre (2 herë në vit) për ndjekjen e arsimit bazë dhe vërtetim për çdo vaksinë të realizuar për fëmijët e tyre, në zbatim të neneve 8 dhe 9 të vendimit nr.955, datë 7.12.2016, të ndryshuar paguajnë tarifën që kanë vendosur vetë institucionet për kryerjen e këtyre shërbimeve (lëshimin e vërtetimeve) të cilat janë shpesh herë të barabarta me përfitimin e përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të vendimit. *Në aktet e miratuara për procedurat e përfitimit të NE dhe PAK dhe në fuqi nuk është e përcaktuar që shërbimet dhe dokumentacioni që është i domosdoshëm për tu lëshuar nga institucionet përkatëse, për efekt të përfitimit të NE dhe PAK, duhet të jetë pa pagesë.*

Gjetje 2

-Nga auditimi në disa Njësi të Qeverisjes Vendore rezultoi se formulari i vërtetimit social ekonomik në familje i plotësuar nga Administratorët Shoqëror nuk ishte realizuar dy herë në vit dhe në disa raste ishte i pa konfirmuar nga të dy palët (Administratori Shoqëror dhe përfituesit e NE), veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e vendimit të KM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteve, procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike”. Gjithashtu shpesh herë Administratorët Shoqërorë ndjenin vështirësi në plotësimin e rubrikave të pyetësorit apo të formularit të vizitave në familje, kjo si pasojë dhe trajnimeve të cilësuar prej tyre të pa mjaftueshme.

-Nga disa NJQV nuk janë ngritur strukturat në formën dhe numrin e duhur për realizimin e funksioneve të Administratorëve Shoqërorë në zbatim të vendimit të KM nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteve , procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike”, të ndryshuar dhe vendimin e KM nr. 956, datë 7.12.2016 “ Për përcaktimin e Kriteve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike”.

- Nga auditimi i disa dosjeve të përfituesve, rezultoi se përfituesit e ndihmës ekonomike të cilët marrin vërtetim në shkollë për fëmijët e tyre (2 herë në vit) për ndjekjen e arsimit bazë dhe vërtetim për çdo vaksinë të realizuar për fëmijët e tyre, në zbatim të neneve 8 dhe 9 të vendimit nr.955, datë 7.12.2016, të ndryshuar, paguajnë tarifën që kanë vendosur vetë institucionet për kryerjen e këtyre shërbimeve (lëshimin e vërtetimeve), të cilat janë shpesh herë të barabarta me përfitimin e përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të vendimit.

Niveli i prioritetit: i lartë

Rekomandim nr.2

a-Nga administratorët e sistemit, me qëllim të monitorimit më efektiv nga SHSSH të procesit të përfitimit të NE, shmangien e formalitetit dhe bërjen transparente të procesit të vlerësimit social ekonomik të përfituesve të NE, të programohet sistemi, që formularët standard të plotësuar nga Administratorët Shoqërorë gjatë vizitave në familje dhe të konfirmuara nga palët, të hidhen të skanuara në sistem dhe jo manualisht (ku ekzistojnë dhe elementët e gabimit njerëzor).

b-Nga MSHMS, detyrimi i hedhjes të formateve të plotësuar në sistem në formë të skanuar, të përcaktohet në aktet rregullative për zbatim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

c- Nga MSHMS që është zbatues dhe mbikëqyrës i projektit të “Modernizimit të Asistencës Sociale”, për arritjen e objektivave të projektit dhe politikave qeveritare “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” në bashkëpunim me NJQV, të ndërmarrë një analizë për të përcaktuar numrin e punonjësve të administratorëve shoqëror që domosdoshmërisht duhet të ketë një NJQV, referuar numrit të banorëve dhe gjendjes sociale të tyre, zhvillimit ekonomik të zonës, dhe numrit të përfituesve të NE dhe PAK të njësisë, duke pasur në konsideratë që njësia ka dhe funksionin e identifikimit të rasteve ekstremist të varfra dhe të pa orientuara referuar politikave shtetërore për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Këto detyrime (për numrin e administratorëve shoqërorë) të udhëzohen në aktet përkatëse të hartuara dhe miratuara nga ministria referuar kompetencës të saj, për zbatim nga NJQV.

Nga MSHMS me shkresën nr.2578/8 datë 27.07.2018 është observuar fakti i nxjerrjes së një akti ligjor të hartuar nga ministria për numrin e domosdoshmëm të administratorëve social për zbatim nga NJQV. Për këtë japim shpjegimin se grupi i auditimit ka përcaktuar se marrja në analizë e numrit të nevojshëm të administratorëve social në NJQV të bëhet nga ministria në bashkëpunim me këtë të fundit dhe akti ku të përcaktohet kjo normativë jo domosdoshmërisht duhet të jetë akt ligjor (grupi i auditimit nuk e ka përcaktuar këtë gjë), por kjo analizë apo studim i përbashkët të jetë në formën e një udhëzuesi apo metodologjie e cila duhet të kihet parasysh nga çdo NJQV aktuale apo e mëvonshme. Referuar këtij opinioni, observacioni i juaj nuk merret në konsideratë

d-Nga MSHMS, deri në konsolidimin e procesit të përfitimit të NE nëpërmjet sistemit dhe aplikimit të formulës së pikëzimit, i cili tashmë po zbatohet në gjithë qarqet e vendit, të gjejë hapësira dhe rrugë të mundshme (tej aktiviteteve të planifikuara dhe realizuara të projektit të “Modernizimit të Asistencës sociale”) për vazhdimin e trajnimit të Administratorëve Shoqërorë, që janë pjesë shumë e rëndësishme e procesit dhe vlerësimit social ekonomik të shtresave në nevojë, me qëllim përfitimin prej tyre të NE. Gjithashtu me qëllim bërjen sa më efektiv të sistemit, të analizohen me prioritet problematikat e konstatuara nga administratorët shoqërorë të Njësisë të Qeverisjes Vendore për ti dhënë zgjidhjen e duhur fenomeneve të rezultuara.

e- Nga MSHMS në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për institucionet e arsimit bazë, të cilat lëshojnë vërtetime dy herë në vit për fëmijët e përfituesve të NE, të përcaktojnë që ky shërbim të kryhet pa paguar tarifën e institucionit për këto shërbime.

Menjëherë

MSHMS me shkresën nr.2578/8 datë 27.07.2018 ka observuar për pikën e dhe f sa mësipër duke theksuar se në institucionet e shëndetësisë dhe të arsimit nuk tarifojnë këto shërbime. Nga grupi i auditimit ky konkluzion është arritur kundrejt fakteve të konstatuara nga vetë grupi për këto pagesa, por merret në konsideratë përcaktimi se nuk merren më vërtetime për vaksinat po fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës, sipas ndryshimeve me VKM nr.592, datë 18.10,2017 dhe

Nuk merret në konsideratë pretendimi që nuk paguajnë për vërtetimet që marrin për ndjekjen e arsimit bazë të fëmijëve në moshë shkollore, pasi nuk u vu në dispozicion referenca ligjore.

C. Inspektimeve të kryera për zbatimin e NE

Në Marrëveshjen e Huamarrjes për projektin “ Modernizimi i Asistencës Sociale” në pjesa Programit 2 “Zbatimi i Projektit” pika B seksioni II/2 theksohet se: “Gjatë zbatimit të projektit, Huamarrësi, nëpërmjet ministrisë do të kryejë inspektime tematike të bazuara në modele për zbatimin e NE , në bazë të atij objekti dhe rregullsisë, siç përcaktohet në manualin operacional të projektit dhe duke mbuluar pa kufizim, nivelin e veprimeve korrigjuese të ndërruara. Raportet e inspektimit tematike i vihen në dispozicion për shqyrtim Bankës dhe Huamarrësit, nëpërmjet ministrisë dhe Bankës i jepet mundësia për të diskutuar dhe për të bërë komente mbi raportet në fjalë. Huamarrësi nëpërmjet ministrisë zbaton menjëherë çdo rekomandim të miratuar që jepet nga Banka në bazë të këtyre vlerësimeve”.

Nga grupi i auditimit, ministrisë, drejtorisë së programit të përkujdesit social si dhe NJP, ju kërkuan vënia në dispozicion i raporteve të inspektimit të kryera referuar përcaktimit sa mësipër dhe rekomandimet e Bankës të rezultuara nga këto raporte. Aktualisht për periudhën objekt auditimi nuk na u bënë prezent ekzistenca e raporteve dhe rekomandimeve përkatëse.

Theksojmë se MSHMS nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror kryen kontrole të pagesave dhe procedurave për NE dhe PAK , për të cilat ka rezultuar gjetja sa më poshtë vijon:

Gjetje 3

SHSSH ka Drejtori Kontrolli për NE dhe pagesat e PAK, e cila kryen kontrole në njësitë vendore për zbatimin e procedurave dhe përfitimin e NE dhe PAK në zbatim të legjislacionit ekzistues dhe në fuqi përgjatë vitit 2017. Gjithashtu kontrole kryhen dhe nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, ku metodologjia e kontrollit (hapat e kontrollit) janë mbështetur në vendimin e KM nr. 512, datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të Ndihmës Ekonomike, të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore” i ndryshuar me vendimin KM nr. 527, datë 23.04.2008, ku objekti i kontrollit dhe dhënia e masave, mbështetur në vendimet sa mësipër janë kompetencë e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, *institucion i pa krijuar.*

Gjithashtu referuar procesit të përfitimit të NE, tashmë me shtrirje mbarë kombëtare, nëpërmjet zbatimit të sistemit dhe formulës së pikëzimit, ka ndryshuar dokumentacioni që administrohet, mënyra e aplikimit, kontrollet e vazhdueshme të përfituesve (në njësi vendore me detyrim paraqitje apo vizita në shtëpi), duke pasur dallim me procedurat e mëparshme. Kjo kërkon domosdoshmërisht miratimin e një metodologjie të re kontrolli të përshtatshme dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi që zbatohen për NE dhe PAK.

Niveli i prioritetit: i lartë

Rekomandimi 3

- Nga MSHMS në bashkëpunim me drejtorinë e politikave dhe SHSSH, të ndërmerret nisma e hartimit të metodologjisë së procedurave të kryerjes së kontrollit të Ndihmës Ekonomike, të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në përshtatje me ndryshimet ligjore dhe aktet në fuqi.

D. Mbi Pagesat e Aftësisë së Kufizuar

Për kryerjen e pagesave të aftësisë së kufizuar në zonat pilot (që janë Njësia administrative nr.6 dhe nr.7 në Tiranë) ka dalë vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 8.06.2016

“ Për përcaktimin e Kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse të detyrave të tyre në zonat pilot”.

Në këto zona pilot referuar vendimit të KM nr. nr. 431, datë 8.06.2016, i ndryshuar, *vendimi përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar*, del nga Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (Tiranë) ku është ngritur dhe Zyra e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Për vitin 2017 për të dy njësitë pilot, nga informacioni i marrë nga Zyra e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, rezultoi se për vendimmarrjet për vendimet përfundimtare për përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët kanë qenë 365 (sipas aplikimit) kanë rezultuar se janë refuzuar 17 aplikime, ku 3 prej tyre kanë ankimuar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.431, datë 8.06.2016 “ Për përcaktimin e Kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse të detyrave të tyre në zonat pilot” është ndryshuar me vendimin 150, datë 13.03.2018, ku në pikën 5 të tij citohet:” Shërbimi Social Shtetëror ngre Komisionin e Shqyrtimit të ankesave, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale”.

Nga verifikimi gjatë periudhës së auditimit, rezultoi se megjithëse ngritja e komisionit të shqyrtimit të ankesave është përcaktuar me akt ligjor me 13.03.2018, shumë kohë pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 431, datë 8.06.2016, ky komision, në Shërbimin Social Shtetëror, nuk është bërë ende funksional.

-Gjithashtu në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.431, datë 8.06.2018, i ndryshuar individit i cili pretendohet të vlerësohet për aftësinë e kufizuar nga komisioni shumë disiplinor dorëzon pranë këtij komisioni ndër të tjera dhe formularin e plotësuar nga mjeku u familjes dhe formularin e plotësuar nga mjeku specialist. Referuar faktit të konstatuar se këto formularë shpesh herë plotësohen jo korrekt, ku dhe shpesh herë rezultojnë rubrika të pa plotësuara, komisioni shumë disiplinor i kthen mbrapsht këto formularë për plotësim të mëtejshme, por kjo marrëdhënie kryhet nëpërmjet individit që ka aplikuar për tu vlerësuar për aftësinë e kufizuar, duke e bërë këtë proces mundësisht dhe të manipulueshëm.

-Referuar procedurës së miratuar për PAK, për përfituesit “Kujdestarë” (ndihmësit personal) për kategoritë jo paraplegjike e tetraplegjike, rezultoi se periudha e kujdestarisë nuk u njihet si vjetërsi pune, në ndryshim me kujdestarët paraplegjike e tetraplegjike. Gjithashtu në çdo aplikim të përfitimit të këtij titulli, kjo kategori referuar procedurës në fuqi, duhet të kryejë një sërë vizitash mjekësore dhe analiza për të vërtetuar që është në gjendje shëndetësore të mirë, kundrejt pagesave, për arsye se konsiderohet si kategori e pasiguar, njëkohësisht nuk konsiderohet kategori e papunë, pra përjashtohet nga të gjitha shërbimet shëndetësore pa pagesë të detyruara për ti bërë në rastet e aplikimit si kujdestarë, por përjashtohet nga shërbimet shëndetësore pa pagesë edhe në rastet e kontrollit dhe shërbimit shëndetësor të nevojshëm për veten e tyre.

Gjetje 4

Nga auditimi rezultoi se akoma nuk është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave referuar vendimmarrjeve të dala, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 8.06.2016 “ Për përcaktimin e Kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar.

-Gjithashtu Formularët e plotësuar nga mjeku i familjes dhe specialist për individin që pretendon të vlerësohet për aftësinë e kufizuar dorëzohen nga vetë aplikuesit të cilët janë shpesh herë dhe ndërmjetësit midis komisionit shumë disiplinor dhe mjekut të familjes e specialist për rastet e kthimit mbrapsht të formularëve si rezultat i plotësimeve jo korrekte ose me mangësi të formularëve duke krijuar kështu premisa për manipulime të formularëve.

-Nga auditimi u konstatua se referuar procedurës së miratuar për PAK, për përfituesit “Kujdestarë” për kategoritë jo paraplegjike e tetraplegjike, periudha e kujdestarisë nuk u njihet si vjetërsi pune, në ndryshim me kujdestarët paraplegjike e tetraplegjike. Gjithashtu në çdo aplikim të përfitimit të këtij titulli, kjo kategori referuar procedurës në fuqi, duhet të kryejë një sërë vizitash mjekësore dhe analiza për të vërtetuar që është në gjendje shëndetësore të mirë, kundrejt pagesave, për arsye se konsiderohet si kategori e pasiguruar, njëkohësisht nuk konsiderohet kategori e papunë, pra përjashtohet nga të gjitha shërbimet shëndetësore pa pagesë të detyruara për ti bërë në rastet e aplikimit si kujdestarë, por përjashtohet nga shërbimet shëndetësore pa pagesë edhe në rastet e kontrollit dhe shërbimit shëndetësor të nevojshëm për veten e tyre gjatë gjithë kohës si kujdestarë. Kjo situatë penalizon këtë kategori individësh të cilët përveç vështirësive që kanë në procesin e kujdestarisë (ku kujdesen për të afërmit dhe shpesh familjarët e tyre) por privohen dhe nga drejta e përfitimit nga shëndetësia falas.

Niveli i prioritetit: i lartë.

Rekomandimi 4

a-Nga Shërbimi Social Shtetëror të ngrihet komisioni i shqyrtimit të ankesave referuar numrit dhe përbërjes së domosdoshme që duhet të ketë ky komision duke e bërë atë funksional edhe për shqyrtimin e ankesave të pa trajtuara dhe të rezultuara nga viti 2017.

b-Nga MSHMS (strukturat përkatëse) dhe administratorët e sistemit, me qëllim shmangien e abuzivitetit të shikohet mundësia e plotësimit online në sistemin, të formularit detyrim për tu plotësuar nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për individin që aplikon për tu vlerësuar për aftësinë e kufizuar. Në këtë proces të vazhdohet me trajnimin gjithëpërfshirës të mjekëve të familjes dhe specialist i rezultuar i domosdoshëm.

c-Nga MSHMS të iniciohet dhe realizohet nisma ligjore për përfshirjen e kujdestarëve (ndihmësit personal) të të gjitha kategorive në skemën e përfitimit të pensionit (për vitet e punës si ndihmës) dhe të shërbimeve shëndetësore falas.

Menjëherë

5. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Kthimi i përgjigjes brenda afatit 20 ditë në mbështetje të nenit 15, germa “j” të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra sipas programeve të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve.

Nga KLSH me shkresën nr.271/7, datë 12.06.2017 është dërguar “Raporti përfundimtar i uditimit dhe Rekomandimet” në lidhje me auditimin e kryer për vitin 2016.

Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me shkresën nr.2903/4, datë 03.07.2017 i është kthyer përgjigje KLSH duke dërguar dhe planin e masave të përgatitur dhe miratuar nga Titullari me dokumentin me nr.2903/3 datë 24.06.2017. Sa më sipër është respektuar afati i kthimit të përgjigjes.

2. Njoftimi i KLSH me shkrim brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Nga KLSH me akt verifikimin me protokoll 4381/2 datë 01.11.2017 është verifikuar ecuria e rekomandimeve. Në bazë të këtij akt verifikimi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm ka kthyer përgjigje me shkresën 4381/5, datë 8.11.2017. Mbjtja e akt verifikimit si dhe shkresa “ Kthim përgjigje “ janë brenda afatit 6 mujor, që konfirmon zbatimin e nenit 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014 , datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

3. Ecuria e rekomandimeve deri ne momentin e auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe akt verifikimit të mbajtur nga KLSH u konstatua se realizimi i mëtejshëm i rekomandimeve paraqitet në nivelin sa më poshtë vijon:

Nga 10 rekomandime të lëna gjithsej janë pranuar rekomandime 10.

Nga 9 “Masat organizative” të lëna gjithsej, janë në proces 2 rekomandime (rekomandimi 2 dhe 3) dhe janë realizuar 7 rekomandime.

Nga 1 rekomandim “Shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit”, referuar argumenteve dhe analizës së kryer nga menaxhimi, ka rezultuar se ky rekomandim është zbatuar.

Në mënyrë të hollësishme realizimi i rekomandimeve paraqitet në ***aneksin nr.1*** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

GJETJET NGA AUDITIMI DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1

Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2017 nga 22 aktivitete të parashikuara që lidhen drejtpërdrejte me realizimin e indikatorëve DLI 4, 7, 11, 12 dhe 14, janë realizuar vetëm 8 aktivitete, 4 janë ende ne proces, dhe 10 aktivitete të cilat kanë lidhje me realizimin e indikatorëve DLI 4,11,12, si dhe përfundimi i aktiviteteve për indikatorët DLI 16 dhe 17 mbeten për tu përmbushur gjatë vitit 2018.

Gjithashtu u konstatua se gjatë periudhës së auditimit me dokumentin nr.3195, datë 14.05,2018 është miratuar Urdhri nr.387, datë 14.05.2018 “ Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve të projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale për vitin 2018” ku në zbatim të tij ngarkohen strukturat e Z/Ministrit,Drejtoria e Zhvillimit të programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS, Ekipi i menaxhimit të Projektit dhe institucionet e vartësisë të MSHMS (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 12-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i prioritetit: i lartë

Rekomandim 1

Nga ana e Njësisë së Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me strukturat e angazhuara në realizimin e aktiviteteve, me qëllim realizimin e objektivave të projektit të modernizimit të asistencës sociale, për rrjedhojë realizimin e indikatorëve (realizimi i 5 DLI të pa realizuara), të ndiqet në mënyrë rigoroz zbatimi i planit vjetor të aktiviteteve të miratuar me urdhrin nr.387, datë 14.05.2018, duke përgatitur raporte progresive të ecurisë së këtij plani për titullarin, me synim mbikëqyrjen dhe marrjen e masave në kohë të eliminimit të risqeve të identifikuara gjatë zbatimit të tij dhe arritjen e realizimit të të gjithë aktiviteteve brenda afateve të programuara dhe vitit 2018, kjo dhe në kuadrin e një menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efijcent.

Gjetje nga auditimi 2

-Nga auditimi në disa Njësi të Qeverisjes Vendore rezultoi se formulari i vërtetimit social ekonomik në familje i plotësuar nga Administratorët Shoqëror nuk ishte realizuar dy herë në vit dhe në disa raste ishte i pa konfirmuar nga të dy palët (Administratori Shoqëror dhe përfituesit e NE), veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e vendimit të KM nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kritereve, procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike”. Gjithashtu shpesh herë Administratorët Shoqërorë ndjenin vështirësi në plotësimin e rubrikave të pyetësorit apo të formularit të vizitave në familje, kjo si pasojë dhe trajnimeve të cilësuar prej tyre të pa mjaftueshme.

-Nga disa NJQV nuk janë ngritur strukturat në formën dhe numrin e duhur për realizimin e funksioneve të Administratorëve Shoqërorë në zbatim të vendimit të KM nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kritereve , procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike”, të ndryshuar dhe vendimin e KM nr. 956, datë 7.12.2016 “ Për përcaktimin e Kritereve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”.

- Nga auditimi i disa dosjeve të përfituesve, rezultoi se përfituesit e ndihmës ekonomike të cilët marrin vërtetim në shkollë për fëmijët e tyre (2 herë në vit) për ndjekjen e arsimit bazë dhe vërtetim për çdo vaksinë të realizuar për fëmijët e tyre, në zbatim të neneve 8 dhe 9 të vendimit nr.955, datë 7.12.2016, të ndryshuar, paguajnë tarifën që kanë vendosur vetë institucionet për kryerjen e këtyre shërbimeve (lëshimin e vërtetimeve), të cilat janë shpesh herë të barabarta me përfitimin e përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të vendimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4/1, faqet 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i prioritetit: i lartë

Rekomandim 2

a-Nga administratorët e sistemit, me qëllim të monitorimit më efektiv nga SHSSH të procesit të përfitimit të NE, shmangien e formalitetit dhe bërjen transparent të procesit të vlerësimit social ekonomik të përfituesve të NE, të programohet sistemi, që formularët standard të plotësuar nga Administratorët Shoqërorë gjatë vizitave në familje dhe të konfirmuara nga palët, të hidhen të skanuara në sistem dhe jo manualisht (ku ekzistojnë dhe elementët e gabimit njerëzor).

b-Nga MSHMS, detyrimi i hedhjes të formateve të plotësuar në sistem në formë të skanuar, të përcaktohet në aktet rregullative për zbatim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

c- Nga MSHMS që është zbatues dhe mbikëqyrës i projektit të “Modernizimit të Asistencës Sociale”, për arritjen e objektivave të projektit dhe politikave qeveritare “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore ” në bashkëpunim me NJQV, të ndërmarrë një analizë për të përcaktuar numrin e punonjësve të administratorëve shoqëror që domosdoshmërisht duhet të ketë një NJQV, referuar numrit të banorëve dhe gjendjes sociale të tyre, zhvillimit ekonomik të zonës, dhe numrit të përfituesve të NE dhe PAK të njësisë, duke pasur në konsideratë që njësia ka dhe funksionin e identifikimit të rasteve ekstremist të varfra dhe të pa orientuara referuar politikave shtetërore për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Këto orientime (për numrin e administratorëve shoqërorë) të udhëzohen në aktet përkatëse të hartuara dhe miratuara nga ministria referuar kompetencës të saj, për zbatim nga NJQV.

d-Nga MSHMS, deri në konsolidimin e procesit të përfitimit të NE nëpërmjet sistemit dhe aplikimit të formulës së pikëzimit, i cili tashmë po zbatohet në gjithë qarqet e vendit, të gjejë hapësira dhe rrugë të mundshme (tej aktiviteteve të planifikuara dhe realizuara të projektit të “Modernizimit të Asistencës sociale”) për vazhdimin e trajnimit të Administratorëve Shoqërorë, që janë pjesë shumë e rëndësishme e procesit dhe vlerësimit social ekonomik të shtresave në nevojë, me qëllim përfitimin prej tyre të NE. Gjithashtu me qëllim bërjen sa më

efektiv të sistemit. të analizohen me prioritet problematikat e konstatuara nga administratorët shoqërore të Njësive të Qeverisjes Vendore për ti dhënë zgjidhjen e duhur fenomeneve të rezultuara.

e- Nga MSHMS në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për institucionet e arsimit bazë, të cilat lëshojnë vërtetime dy herë në vit për fëmijët e përfituesve të NE, të përcaktojnë që ky shërbim të kryhet pa paguar tarifat e institucionit për këto shërbime.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi 3

Shërbimi Social Shtetëror ka Drejtorin Kontrolli për NE dhe pagesat e PAK, e cila kryen kontrole në njësitë vendore për zbatimin e procedurave dhe përfitimin e NE dhe PAK në zbatimin të legjislacionit ekzistues dhe në fuqi përgjatë vitit 2017. Gjithashtu kontrole kryhen dhe nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, ku metodologjia e kontrollit (hapat e kontrollit) janë mbështetur në vendimin e KM nr. 512, datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të Ndihmës Ekonomike, të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore” i ndryshuar me vendimin KM nr. 527, datë 23.04.2008, ku objekti i kontrollit dhe dhënia e masave, mbështetur në vendimet sa më sipër janë kompetencë e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, *institucion i pa krijuar*.

Gjithashtu referuar procesit të përfitimit të NE, tashmë me shtrirje mbarë kombëtare, nëpërmjet zbatimit të sistemit dhe formulës së pikëzimit, ka ndryshuar dokumentacioni që administrohet, mënyra e aplikimit, kontrollet e vazhdueshme të përfituesve (në njësi vendore me detyrim paraqitje apo vizita në shtëpi), duke pasur dallim me procedurat e mëparshme. Kjo kërkon domosdoshmërisht miratimin e një metodologjie të re kontrolli të përshtatshme dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi që zbatohen për NE dhe PAK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4/1, faqet 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i prioritetit: i lartë

Rekomandimi 3

- Nga MSHMS në bashkëpunim me drejtorinë e politikave dhe SHSSH, të ndërmerret nisma e hartimit të metodologjisë së procedurave të kryerjes së kontrollit të Ndihmës Ekonomike, të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në përshtatje me ndryshimet ligjore dhe aktet në fuqi.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi 4

Nga auditimi rezultoi se akoma nuk është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesave referuar vendimmarrjeve të dala, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 8.06.2016 “ Për përcaktimin e Kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar.

-Gjithashtu Formularët e plotësuar nga mjeku i familjes dhe specialist për individin që pretendon të vlerësohet për aftësinë e kufizuar dorëzohen nga vetë aplikuesit të cilët janë shpesh herë dhe ndërmjetësit midis komisionit shumë disiplinor dhe mjekut të familjes e specialistit për rastet e kthimit mbrapsht të formularëve si rezultat i plotësimeve jo korrekte ose me mangësi të formularëve duke krijuar kështu premisa për manipulime të formularëve.

-Nga auditimi u konstatua se referuar procedurës së miratuar për PAK, për përfituesit “Kujdestarë” për kategoritë jo paraplegjikë e tetraplegjikë, periudha e kujdestarisë nuk u njihet si vjetërsi pune, në ndryshim me kujdestarët paraplegjikë e tetraplegjikë. Gjithashtu në çdo aplikim të përfitimit të këtij titulli, kjo kategori referuar procedurës në fuqi, duhet të kryejë një sërë vizitash mjekësore dhe analiza për të vërtetuar që është në gjendje shëndetësore të mirë, kundrejt pagesave, për arsye se konsiderohet si kategori e pasiguar,

njëkohësisht nuk konsiderohet kategori e papunë, pra përjashtohet nga të gjitha shërbimet shëndetësore pa pagesë të detyruara për ti bërë në rastet e aplikimit si kujdestarë, por përjashtohet nga shërbimet shëndetësore pa pagesë edhe në rastet e kontrollit dhe shërbimit shëndetësor të nevojshëm për veten e tyre gjatë gjithë kohës si kujdestarë. Kjo situatë penalizon këtë kategori individësh të cilët përveç vështirësive që kanë në procesin e kujdestarisë (ku kujdesen për të afërmit dhe shpesh familjarët e tyre) por privohen dhe nga e drejta e përfitimit nga shëndetësia falas (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4/1, faqet 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i prioritetit: i lartë.

Rekomandimi 4

a-Nga Shërbimi Social Shtetëror të ngrihet komisioni i shqyrtimit të ankesave referuar numrit dhe përbërjes së domosdoshme që duhet të ketë ky komision duke e bërë atë funksional edhe për shqyrtimin e ankesave të pa trajtuara dhe të rezultuara nga viti 2017.

b-Nga MSHMS (strukturat përkatëse) dhe administratorët e sistemit, me qëllim shmangien e abuzivitetit të shikohet mundësia e plotësimit online në sistemin, të formularit detyrim për tu plotësuar nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për individin që aplikon për tu vlerësuar për aftësinë e kufizuar. Në këtë proces të vazhdohet me trajnimin gjithëpërfshirës të mjekëve të familjes dhe specialist i rezultuar i domosdoshëm.

c-Nga MSHMS të iniciohet dhe realizohet nisma ligjore për përfshirjen e kujdestarëve (ndihmësit personal) të të gjitha kategorive në skemën e përfitimit të pensionit (për vitet e punës si ndihmës) dhe të shërbimeve shëndetësore falas.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi 5

Gjatë periudhës së auditimit është konstatuar se nga Huamarrësi nuk ka ende një njoftim për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2017, ku afati kohor i përcaktuar në marrëveshje është deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës. Gjithashtu referuar përcaktimeve në marrëveshje, detyrimi për realizimin e auditimit të pasqyrave financiare është i huamarrësit, pra i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga Njësia e Projektit nuk rezultoi komunikim zyrtar me huamarrësin direkt, në lidhje me iniciimin e procedurave për auditimin e pasqyrave financiare pavarësisht përgjegjësisë dhe detyrimit për këtë proces. Në faqet web përkatëse të Ministrive nuk janë venë në dispozicion të publikut pasqyrat financiare sipas kushteve të marrëveshjes, detyrim i huamarrësit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 6-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i prioritetit: i mesëm

Rekomandim 5

Nga Njësia e Projektit të merren masa që me shkresën përcjellëse të dorëzimit të pasqyrës financiare për vitin përkatës në Ministri të Financës dhe Ekonomisë, të theksohet dhe të iniciohet disponueshmeria e Njesisë së Projektit për auditimin e pasqyrave financiare, referuar afateve të përcaktuara në marrëveshjen e huas, brenda muajit Qershor, si dhe vënies në dispozicion të tyre për publikun, mbas auditimit, nëpërmjet faqes web edhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që luan rolin e liderit në zbatimin e këtij projekti.

Vazhdimisht

Gjetje nga auditimi 6

Nga auditimi ka rezultuar se Pasqyrat financiare të hartuara për vitin 2017 (plotësimi i formateve përbërës të pasqyrave financiare) paraqesin të dhënat për shpenzimet e vitit të mbyllur 2017 (1Janar- 31 dhjetor) dhe të vitit paraardhës 2016 (1 janar dh- 31 Dhjetor).

Këto pasqyra në plotësimin e formatit nr.1(aktivi) dhe nr.2 (pasivi) në rubrikat përkatëse nuk kanë pasqyruar të dhëna progresive që nga fillimi i projektit, veprim që bie në kundërshtim me kapitullin IV dhe Kapitullin III të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, date 28

.12 .2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve qe varen prej tyre si dhe te njësisve te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj”, të ndryshuar, *përkatësisht paragrafët ku citohet:*

“Formati i llogarive vjetore te njësisve te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj është i njëjte me atë qe miratohet me këtë udhëzim. Për përgatitjen e pasqyrave financiare ato zbatojnë te njëjtat procedura e kritere te përcaktuara ne rubrikat përkatëse te këtij udhëzimi”, si dhe

”Shpjegime lidhur me përmbajtjen dhe plotësimin e pasqyrave financiare te vitit..”

“1. Për Aktivin e Bilancit kontabël (Formati nr. 1)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet aktivitet te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.2.....).

2. Për pasivin e bilancit kontabël (Formati nr.2)

Informacioni kontabël për te gjitha rubrikat dhe postet pasivit te bilancit kontabël plotësohen ne dy kolona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/.....) dhe ushtrimi paraardhës (tepricat me 01.01.....)”, paragrafë që domosdoshmërisht kërkojnë të dhëna progresive (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 17-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Niveli i prioritetit: i mesëm

Rekomandim 6

a-Nga Njësia e Zbatimit të Projektit të përgatitjen pasqyrat financiare(formatet përkatës) me të dhënat progresive nga fillimi i projektit deri në fund të vitit 2017, në zbatim të procedurave të paraqitura në udhëzimet e miratuara nga Ministria e Financave.

Menjëherë

b-Nga Njësia e Zbatimit të Projektit, Pasqyrat Financiare progresive deri në fund të vitit 2017, të jenë baza për përgatitjen e Pasqyrave Financiare të vitit 2018 dhe përfundimit të projektit, duke qenë se “Projekti i Modernizimit të asistencës sociale” e ka afatin e përfundimit 31.12.2018.

Në vazhdim

Gjetje nga auditimi 7

Nga auditimi i transaksioneve, që nga çelja e fondeve buxhetore nga SHSSH, dalja e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë (VKB) dhe miratimi i afateve të hyrjes së fuqi të tyre, konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut deri tek miratimi i listës së përfituesve të NE dhe PAK dhe për rrjedhojë kryerja e pagesave përfituesve, ka rezultuar se ka vonesa referuar afateve të çeljes së fondeve buxhetore nga SHSSH dhe daljes së VKB, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 4 datë 11.03.2014 “Për planifikimin e fondeve për NE”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr.3, datë 10.03.2014 “ Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” të ndryshuar si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e Kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE”, të ndryshuar. Gjithashtu referuar procedurave të ndjekura me aktet ligjore të miratuara dhe udhëzimet për zbatim të tyre në fuqi, rezultoi se nuk ka të përcaktuar afat kohor maksimal të daljes së listës së përfituesve nga sistemi me formulë pikëzimi nga SHSSH si dhe nuk ka afat maksimal të miratimit të urdhër shpenzimeve nga NJQV për pagesat e NE dhe PAK. Gjithashtu u konstatua se NJQV marrin konfirmimin ligjor nga Prefekti i Qarkut referuar nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, për vendimin e Këshillit Bashkiak për numrin e përfituesve dhe fondet respektive (miratim që vonon procesin dhe rezultoi i pa dobishëm kur miratimi i listës së përfituesve realizohet nga sistemi me formulë pikëzimi për NE dhe nga komisioni apo kempit epror për përfituesit e PAK dhe

fondet janë fonde buxhetore për funksione të deleguara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4/1, faqet 26-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i riskut: i mesëm

Rekomandim 7

a-Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një menaxhim sa më të mirë të afatit kohor mujor për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, në udhëzimet për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave për Pagesat e Aftësisë së Kufizuar dhe Ndihmës Ekonomike, të përcaktohen afatet për çdo proces dhe Institucion (SHSSH dhe NJQV) dhe kryesisht cilësimin për vendimin e SHSSH të listës së përfituesve të NE dhe PAK (njësitë pilot) dhe afatit maksimal të miratimit të urdhër shpenzimit të pagesave për këto kategori nga NJQV, afate të papërcaktuara në aktet dhe udhëzimet në fuqi.

b-Nga MSHMS në aktet sa më sipër cituam, të përcaktohet dhe fakti se për këto pagesa, referuar legjislacionit në fuqi për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të NE dhe PAK, si dhe fondeve buxhetore për këto pagesa të cilat jepen nga institucionet qendrore, marrja e konfirmimit nga Institucioni i Prefektit për ligjshmërinë e numrit dhe pagesës për përfituesit e NE dhe PAK, del jashtë kompetencës së këtij institucioni.

Menjëherë

OPINIONI I AUDITIMIT

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar Raportet Financiare Vjetore të Programit Ndihma Ekonomike (NE) dhe Pagesat e Aftësisë së Kufizuar (PAK), të përgatitura nga Projekti “Modernizimi i Asistencës Sociale” në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 1 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) raporton një opinion për vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare. Ekzaminimi i Raporteve Financiare për vitin 2017, është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për Institucionet Supreme të Auditimit ISSAI 1000-2999, të INTOSAI-t, ISSAI 200, ISSAI 300 dhe ISSAI 400 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), duke fokusuar veprimtarinë në transaksionet financiare të kryera nën Programin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesat për Aftësinë e Kufizuar si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin, lidhur me fondet e lëvruara nën këtë komponent. Mbështetur në këto Standarde ky auditim është planifikuar dhe kryer duke arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat dhe raportet financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Baza për opinionin e pasqyrave financiare:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Nën Komponentin 1, shpenzimet aktuale nën Programin Buxhetor “Ndihma Ekonomik”, për periudhën objekt auditimi 1 janar 2017– 31 Dhjetor 2017, përfshijnë shumën **4,819,335.56 mijë lekë dhe për PAK 15,744,063.12 mijë lekë.**

Auditimi u fokusua në:

- *Raport Progresin e Projektit SAMP, që përfshin Raportet Periodike (3- mujore), të Zyrës së Menaxhimit të Projektit (PMT) në MSHMS për donatorin, Banka Botërore/ IBRD*
- *Raportet Financiare Vjetore të Projektit SAMP, për Programin e Ndhmës Ekonomike, dhe Pagesat e Aftësisë së Kufizuar të Përgatitura;*
- *Raportet e monitorimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2017 së bashku me rakordimet me Ministrinë e Financave.*

Auditimi mbi “*Programin e Ndhmës Ekonomike*” dhe “*Pagesat e Aftësisë së Kufizuar*” siguron një bazë të arsyeshme, sikurse është trajtuar në Raportin Përfundimtar, për opinionin e auditimit si më poshtë:

Opinion i Pakualifikuar;

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare për vitin 2017 japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nr. 200)

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh cilësinë dhe saktësinë e informacioneve të regjistruara në raportet financiare si dhe pajtueshmërinë me kornizën raportuese.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT